



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXIV / Nr. 04 / Prill 2025



HAXHI

Një udhëtim i përmallshëm



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsb.al


Viti XXXIV i botimit

Nr. 04 (503)


Prill, 2025

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al



editorial

- 04** Haxhi, një udhëtim i përmallshëm
Mehmet Disha

në fokus

- 06** Padrejtësia ndëshkohet
Dorian Demetja

lajme / aktivitete

- 08** 01-Komuniteti Mysliman i Shqipërisë shtron iftarin e parë të Ramazanit
02-Zhvillohet konferenca ndërkombëtare: "Ndërtimi i urave ndërmjet medhhebeve dhe sekteve"
03-Ambasadori i Emirateve të Bashkuara Arabe viziton KMSH-në
04-E ngarkuara me punë e Ambasadës së SHBA-së në Tiranë viziton KMSH-në
05-Mijëra besimtarë myslimanë të kryeqytetit dhe jo vetëm, festojnë Fitër Bajramin
06-Personalitete dhe përfaqësues institucionesh urojnë besimtarët për Fitër Bajram

refleksione

- 14** Haxhi përmes historisë dhe përjetimit
Lauren Luli

çështje fetare

- 20** Disa pyetje dhe përgjigje rreth Haxhit dhe Kurbanit
Redaksia

familja

- 22** Namazi dhe gruaja myslimane – një lidhje që i jep shpirt jetës / Fatma Karaj

horizonti i besimit

- 24** A mundet Islami të balancojë etikën me progresin modern / Alizaman D. Gamon, Mariam S. Tagoranao
28 Kurhani, thelbi sublim i bindjes dhe përkushtimit
Tauland Bica
30 Qabja e madhnueshme, vendi i shenjtë i myslimanëve / Armand Asllani
32 Vetëm kush vjen me zemër të pastër...
Leonard Çela

bota shpirtërore

- 34** Vlera e dhjetë ditëve të para të muajit Dhu'l-hixhe
Resul ef. Rexhepi

hapësirë femërore

- 36** Pena është një pemë, frytet e saj janë fjalët
Redaksia

këndi i poezisë

- 38** Miliona haxhinj - miliona dashuri
Mexhid Yvejsi



Haxhi, një udhëtim i përmallshëm



Udhëtimi në mënyrë të përgjithshme është lidhur gjithnjë ngushtë me zbulimin e vendeve të reja. Njeriu, shpesh i zënë në rutinën dhe në gjeografinë e po të njëjtave përjetime të përditshmërisë, shtyhet të njohë shtigje të reja, përjetime qoshesh, sokakësh dhe njerëzish të kulturave të ndryshme dhe kjo zgjon tek shpirti i tij ndryshimin dhe lëvizjen në vetvete. Lëvizja dhe ndryshimi i sjellin freski mendjes, ashtu siç rrjedha e mban gjallë ujin. Rutina e punës, pirja e kafes në po të njëjtat kafene, ulja me po të njëjtit njerëz, dynjaja në vetvete dhe bisedat e përkosmërisë, shpeshherë të padobishme, nuk e mbushin më zemrën me ajrin që i duhet, kështu atë e thërret udha...

Së dyti, llojit të udhëtimit i shtohet edhe ai historik, ku njeriu priret të njohë historinë e njerëzve dhe vendeve që dikur patën një madhësi gjallimi, e që tashmë qëndron mbi dhé vetëm gjurma e tyre e shkuar. Mbretëri të rëna, kështjella, vepra arti që u qendrisën nga duar të tjera në të shkuarën faksin me misterin e tyre të vjetëruar por jo të plakur, të paprekur nga koha. Ky udhëtim lidh tek shpirti urat e shekujve dhe mijëvjeçarëve...

Mirëpo, ka edhe një lloj tjetër udhëtimi, për të cilin rrallëpak flitet, i cili vihet në specifikë edhe nga një hadith profetik, ku fjalëurti i Dërguar i Allahut a.s. na lë si porosi: "Tri janë vendet të cilat njeriu merr udhën t'i vizitojë: Mesxhidi Haram (Qabja), Mesxhidi Aksa, dhe kjo xhami e imja (pra xhamia e Resulullahut në Medinen e Shndritshme)." Të trija këto vende kanë si specifikë të përbashkët faktin se janë xhami pejgamberësh. Ky lloj udhëtimi shkon përtej të resë dhe të vjetrës, ndonëse në pikëpamje të parë ne priremi të mendojmë historikun e të tri xhamive, këtu nuk kemi të bëjmë veçse me urën mes të shkuarës dhe të tashmes së shpirtit të njeriut, e aq më pak mes të tashmes dhe të ardhmes së tij. Shpalosja e kaderit dhe e jetës për njeriun është mister që i përket të fshehtës dhe që askush nuk e di e as që mund ta zbulojë, përveçse duke e jetuar. Ama, nuk është ky qëllimi. Çfarë ka kaluar, ka kaluar dhe çfarë ka për të ardhur, ka për të ardhur.

Ky udhëtim ka të bëjë me gjenezën e gjithçkaje, me kërkimin e fillit nistor, me burimin nga ku nisi krijimi dhe nga ku doli shpirti. Kërkimi i strehës është qëllimi. Në hadithin e mësipërm Profeti i nderuar a.s. nuk është se ndalon vizitën e vendeve apo xhamive të tjera, ama sikur do të thotë: Më të mirat e vendeve që mund të vizitohen dhe që ja vlen të merret parasysh lodhja e mundimi i rrugës janë këto të trija. Njëra është streha e parë që sipas edhe Ibn Abbasit, është shtëpia e parë që u ndërtua nga engjëjt për profetin Adem a.s., njeriu i parë, dhe që më vonë, profeti Ibrahim a.s. e rindërtoi dhe rinorri në pah themelet e vjetra të saj. E kështu me radhë, këto faltore të ndërtuara nga profetët bëhen udha e pastër e cila zgjatet për ata që duan të udhëtojnë për tek Zoti i tyre. Tek këto tri xhami namazi ka më shumë vlerë dhe adhurimi ka më shumë sevape. Po a nuk na qartëson Zoti në Kuran se shtëpia e parë, apo faltarja e parë e ndërtuar për njerëzit në tokë është Qabja në Mekën e bekuar?!

Haxhi, i cili është bërë detyrim për ata që i përmbushin kushtet, dhe që është një nga pesë shtyllat e fesë Islame, është pikërisht ky fill i gjetur. Është për këtë arsye që, ata që kurrë nuk rendën në rrugë për të kërkuar, shpirti i të cilëve nuk ndjeu kurrë mall, e që nuk u përzhitën nga mungesa e gjatë e takimit, nuk mundet kurrsesi ta kuptojnë mallin e një haxhiu. Ata që nuk ndoqën fillin e profetëve, që nuk u gjendën në gjurmët e tyre, ata që e humbën fillin pra, dhe nuk panë dritën e shpalljes që Zoti u dha zemrave të profetëve, që na e përcolloën me aq mundim e zell e përkushtim të jashtëzakonshëm, enden duke vizituar muzetë, piramidat, rrënojat në mënyrë të pashpresë për të kërkuar atë: fillin.

Ama nuk ka rëndësi se sa e mundimshme qe sflitja duke kërkuar gjetkë atë që fshihej brenda në ashtin e truallit të shpirtit, kudo që të gjendet, njeriu me zemrën kërkuese dëgjon kumtin hyjnor "Kudo që të jeni, kthejini fytyrat tuaja në drejtim të Mesxhidi Haramit (Qabes)". Kështu shpaloset tabloja madhështore e haxhit. Miliona besimtarë të përmalluar që adhurojnë Zotin e tyre.

Mbi Qabe, në një linjë të drejtë që tejkalon fizikën dhe që grish metafizikën, Allahu krijoi poshtë Arshit të Tij një shtëpi të quajtur Bejtu'l Ma'mur, rreth së cilës bëjnë tavaf engjëjt. Në gjegjësen e saj, rreth Qabes në dynja, bëjnë tavaf besimtarët. Ky adhurim i ngazëllyeshëm i engjëjve, i njerëzve, dhe i xhindeve, ky unifikim i pamatë, është manifestimi i monoteizmit, i njëshmërisë së Zotit i Cili qëndron larg çdo të mete dhe larg çdo idhujtarie që i atribuohen nga ata që e humbën fillin.

Ata që kërkuar, gjetën. Ata që patën mall, u panë. Ata që deshën, u takuan. Gjeti oazin e saj ajo etje e brendshme e zemrës dhe e shpirtit për atë ujë përjetësie, për atë ab-i hajat, që buron prej fjalës së Allauht, kur tha: "... Kur i dhashë njeriut formë të bukur dhe i fryva atij prej Shpirtit Tim..." si edhe mallit për kujtesën apriori të kumtit:

"A nuk jam Unë Zoti juaj?

Thanë: "Kalú belá - S"ka dyshim që po, dëshmuam që je!"

Haxhi është besnikëri ndaj besës së dhënë. Me fillin e gjetur në dorë, besimtari lidhet pas atij litari të fortë të Allahut dhe tashmë dynjaja për të është thjesht një udhë kalimi nga Zoti për tek Zoti. Cilat re mund ta errësojnë qiellin e asaj zemrë që i besoi Allahut? Asnjë errësi nuk e terratis, asnjë pellg i thellë nuk arrin ta mbysë, asnjë pus i thepisur nuk arrin ta ngërthejë, asnjë burg nuk arrin ta kufizojë, asnjë plagë nuk arrin ta gjunjëzojë, asnjë lodhje nuk arrin ta mposhtë. Horizontet e larta të mbushura me engjëjt e afërt të Zotit, me profetët, me njerëzit e devotshëm grishin vazhdimisht shpirtat e etur për përjetësi dhe në këtë rrugë të ndritur, e keqja nuk hedh dot rrënjë.

Zot na bashko me të sinqertët dhe me udhën tënde të Drejtë. Zot mos na e humb fillin. Zot udhëzoje këdo drejt këtij filli të pakëputshëm dhe na mundëso të përjetojmë madhësitinë e mirësisë Tënde në këtë botë dhe në botën e përhershme! Amin!

Padrejtësia ndëshkohet!



Të flasësh për drejtësi në ditët e sotme është një temë sa aktuale aq edhe e nevojshme, sepse thuajse kudo mbizotëron padrejtësia. Padrejtësia apo zullumi është e pranishme në forma të ndryshme, në kohë dhe hapësirë, dhe është karakteristike e njerëzve të këqij, e grupeve, madje edhe e popujve të këqij. Ajo është shkaku i shkatërrimit të njerëzve dhe shoqërisë, i familjeve dhe individëve. Kur përhapet padrejtësia në një shoqëri, atëherë zhduket bereqeti, zvogëlohet mirësia dhe përhapen sëmundjet e dënimit.

Dijetarët myslimanë kur e përkufizojnë padrejtësinë, thonë se ajo është vendosja e gjërave në vendin që nuk u përket, si dhe veprimi me pasurinë dhe të drejtat e të tjerëve në kundërshtim me parimet e drejtësisë. Allahu i Madhëruar, edhe pse ka mundësi të bëjë ç'të dojë, kur të dojë dhe kujt të dojë, Ai nuk i bën zullum askujt. Në një hadith kudsij, Allahu i Plotfuqishëm thotë: **“O robërit e Mi, Unë Vetvetes ia kam ndaluar padrejtësinë, prandaj as ju mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit...”** (Muslim)

Padrejtësia është prej gjynaheve të mëdha, e cila të çon në ndëshkimin e Allahut. Kur çdo gjë këputet me hollimin e saj, te zullumi ndodh ndryshe, ajo këputet kur trashet. Ndonjëherë të padrejtët, për shkak se nuk ndëshkohen aty për aty, mashtrohen dhe kështu zhyten thellë e më thellë në padrejtësi. Kjo nuk nënkupton se ata i shpëtojnë dënimit të Allahut të Madhëruar, përkundrazi, Allahu i Plotfuqishëm i monitoron zullumqarët dhe i lë ata deri në një afat të caktuar, për të mbyllur çdo derë justifikimi. Ndërsa në Ditën e Gjykimit ata do ta marrin dënimin e merituar.

Ka shumë argumente në Kuran dhe Sunet, të cilat e ndalojnë myslimanin të bëjë padrejtësi, por edhe t'i ndihmojë zullumqarët për të bërë padrejtësi. Allahu i Plotfuqishëm urdhëron e thotë: **“E ti kurrësi mos e mendo Allahun si të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë zullumqarët; Ai, vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën kur sytë e tyre shtangen (do të mbesin hapur).** (Ibrahim, 14:42) “Dhe mos anoni nga ata që bënë zullum, e për atë shkak t’ju kapë zjarri, sepse përveç Allahut nuk keni mbrojtës, e mbeteni të pa ndihmuar.” (Hud, 11:113)

Edhe në të kaluarën ka pasur njerëz që, kur ishin në ndonjë pozitë të lartë u bënë padrejtësi të tjerëve. Ata menduan se do të mbeteshin përgjithmonë të pamposhtur dhe e harruan Krijuesin e Gjithësisë. Në hadithin të cilin e përcjell Buhariu thuhet: **“Allahu më të vërtetë i jep kohë zullumqarit, por kur e kap, nuk e lë atë!”** Pastaj e lexoi ajetin: **“I tillë është dënimi i Zotit tënd, kur ndëshkon vendbanimet që bënin zullum. Me të vërtetë, dënimi i Tij është i dhembshëm dhe i ashpër.”** (Hud, 11:102)

Misioni më i rëndësishëm i Profetit Muhamed (a.s.) dhe detyra e çdo myslimani që ndjek rrugën e tij, është përcjellja e mesazheve të Allahut, kumtimi i të drejtës dhe të vërtetës. Ai parashton se ftesa e njerëzve për tek e mira dhe pengimi i tyre nga e keqja bart një rëndësi të madhe për shoqërinë. Duke porositur si më poshtë, Profeti (a.s.) ka qartësuar se detyra e kundërshtimit të së keqes është pjesë e besimit: **“Kush nga ju sheh një të keqe, ta rregullojë me dorë; po të mos ketë mundësi,**

ta rregullojë me gojë dhe, po të mos ketë mundësi as për këtë, ta përbuzë me zemër, gjë që është forma më e dobët e besimit!"(Muslim, Iman, 78).

Gjendja e atyre që nuk e kryejnë detyrën e kumtimit parashtrohet kështu në hadithin profetik: *"Në kohën kur mes bijve të Izraelit, padrejtësia dhe dhuna morën përhapje të gjerë, ndodhte që ata, për hir të interesit, nuk ia vinin në dukje të metat njëri-tjetrit dhe nuk e pengonin njëri-tjetrin kur e shihnin se po vepronin keq. Atëherë Zoti i lëshoi ata kundër njëri-tjetrit dhe zbriti për ta këto ajete. Kështu, edhe ju, ose i bëheni pengesë padrejtësisë dhe dhunës, duke e tërhequr atë që bën padrejtësi dhe dhunë tek e drejta, ose do t'ju bjerë mbi kokë e njëjta gjë!"* (Ibn Maxhe, Fiten, 20; Tirmidhi, Tefsiru Sureti'l-Maide, 7). **"Ata izraelitë që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Dautit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!"** (Maide, 5:78-79). Në një hadith tjetër, në lidhje me këtë çështje, Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: *"Betohem në Allahun që ma ka dhuruar jetën se ju ose do të urdhëroni për të mirë e do të pengoni të keqen, ose Allahu do të dërgojë mbi ju një ndëshkim. Atëherë do të luteni, por lutja nuk do t'ju pranohet!"* (Tirmidhi, Fiten, 9).

Mendimtari i njohur mysliman Ibn Halduni, ka bërë me dije për ngatërresat që shkakton padrejtësia. Ai thotë: "Sa më shumë njerëzit humbasin besimin te ligji dhe drejtësia, aq më shumë shtohet kaosi dhe është shenja e parë e nevojës për reforma. Ligji (drejtësia) është mendja, inteligjenca e një kombi, dhe kur e humbin atë, pra ligjin, humbin mendjen. Një nga padrejtësitë më të rënda dhe më e rrezikshmja për rrënimin e shoqërisë është detyrimi i padrejtë dhe shfrytëzimi i padrejtë i klasës punëtore. Plaçkitja e pasurisë së popullit e zhduk iniciativën për fitimin e pasurisë, sepse ata e shohin se qëllimi i asaj padrejtësie është që njerëzit të mbeten pa pasuri. Kur iniciativa zhduket, duart nuk kanë fuqi dhe njerëzit nuk bëjnë më përpjekje për të arritur diçka... Nëse vjen deri te rënia e vullnetit - dëshirës për të fituar mjete për jetesë dhe nëse duart e tyre dobësohen për të fituar të ardhura, atëherë tregu dhe e gjithë situata sociale dështojnë dhe njerëzit emigrojnë në vende të tjera në kërkim të lumturisë që u është zhdukur. Popullsia zvogëlohet, familjet pakësohen, qytetet shemben. Shpërbërja e shoqërisë çon në rënien e shtetit dhe të pushtetarëve, sepse ata janë vetëm forma të jetës shoqërore, dhe forma humbet domosdoshmërisht nëse humbet materia".

Në kryeveprën e tij "Mukadime", Ibn Halduni tregon për një tjetër pasojë të padrejtësisë, e cila dëshmon se, edhe pse koha dhe rrethanat kanë ndryshuar, disa gjëra mbeten të njëjta. Ai thotë: "Kur shtetet fillojnë të shpërbëhen, shtohen gënjeshtarët e mendjemëdhenjtë, thashethemet përhapen, njerëzit përfshihen në

debate shumë të gjata dhe të kota, njohuritë e vërteta zvogëlohen dhe dyshimet rriten."

Duhet të dimë se padrejtësia ose zullumi është tre lloje: Lloji i parë është padrejtësia e njeriut ndaj Zotit të tij, përmes mosbesimit dhe formave të ndryshme të idhujtarisë. Lloji i dytë është padrejtësia e njeriut ndaj vetvetes, duke i braktisur gjërat e urdhëruara, duke ndjekur egon dhe duke bërë gjynahe. Lloji i tretë është padrejtësia e njerëzve ndaj njëri-tjetrit, duke i marrë jetën, nderin, si dhe duke i privuar ata nga të drejtat dhe pronat e tyre.

Për mëkatin që është mes teje dhe Allahut, ka shpresë se Allahu është Falës dhe do ta falë. Nëse mëkati është mes teje dhe njerëzve të tjerë, atëherë nuk ka shpresë tjetër vetëm se ta falë ai që e ke dhunuar, që i ke hyrë në hak, e ke ofenduar, ke shpifur, e ke përgojuar apo që i ke bërë ndonjë dëm. Zullumqari do të duhej të pendohet për padrejtësinë që u ka bërë tjetërve dhe të kërkojë mundësinë për të marrë hallallikun prej atij që i ka bërë dëm, duke qenë akoma në dynja.

Pendimi për padrejtësinë është kërkimfalja ndaj personave që u është bërë e padrejta. Transmetohet prej Ebu Hurejres se i Dërguari (a.s.), ka thënë: *"Kush i ka bërë ndonjë të padrejtë vëllait të vet mysliman, qoftë morale apo materiale, le të kërkojë sot t'ia falë dhe t'ia bëjë hallall, para se të vijë dita kur nuk do të ketë as dinarë, as dërhëmë. Atë ditë do të merren prej veprave të mira të tij, nëse do t'i ketë, aq sa vlen ofendimi që ka bërë. Nëse nuk do të ketë vepra të mira, atëherë do të merren prej mëkateve të atij që i është bërë padrejtësi dhe do t'i ngarkohen atij."* (Buhariu dhe Muslimi).

Padrejtësia është burimi i të gjitha të këqijave. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar nuk i do zullumqarët dhe nuk e udhëzon popullin zullumqar. Kur i Dërguari i Allahut vendosi ta dërgonte Muadhin në Jemen, e këshilloi me fjalët: *"Ruaju lutjes së atij që i është bërë padrejtësi, sepse me të vërtetë ndërmjet lutjes së tij dhe Allahut nuk ka kurrfarë perdeje (pengese)." (Buhari)* Guvernatori i një province i kishte shkruar halifit Omer Ibn Abdulazizit: "Qyteti ynë ka nevojë t'ia ndryshojmë muret rrethuese!" Halifi i ishte përgjigjur: "Mbroni qytetin tuaj me drejtësi, jo me mure rrethuese, ndërsa rrugët e tij pastrojini nga zullumi!"

Lusim Allahun e Plotfuqishëm të na bëjë njerëz të singertë dhe të na ruajë nga zullumi. Allahu na ruajte besimin në zemrat tona, na forcoftë në këtë Fe, na bëftë të jetojmë si myslimanë, të vdesim si myslimanë dhe të ringjallemi si myslimanë. Lusim Zotin të na bëjë udhëheqës të umetit në devotshmëri, në bujari, në guxim, në modesti e përlulesi!

O Zot! Udhëzoji fëmijët e pasardhësit tanë dhe bëji ata gëzimi i syve dhe i zemrave tona. Na mëshiro në Ditën e Gjykimit dhe na ndero me Xhenet, në shoqëri me profetët, me të singertët, me dëshmorët dhe me njerëzit e mirë!

01 KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË SHTRON IFTARIN E PARË TË RAMAZANIT



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka shtruar mbrëmë iftarin e parë të Ramazanit, ku morën pjesë Kryetarja e Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, përfaqësues të komuniteteve fetare në vend, ambasadorë, përfaqësues të partive politike, personalitete publike, gazetarë, zyrtarë qendror dhe lokal, sipërmarrës, myftinj, imamë dhe besimtarë.

Kryetari i Komunitetit Mysliman, H. Bujar Spahiu, i uroi të pranishmëve mirëseardhjen duke shtuar se Ramazani është muaj reflektimi, dashurie dhe paqeje.

“Ramazani është më shumë se një periudhë kohore e agjërimit dhe e sakrificës; është një mundësi për të rishikuar dhe rivlerësuar qëllimin dhe thelbin e jetës. Ky muaj i bekuar është një udhëtim shpirtëror, që na fton të përballim kufizimet e trupit për të shpërblyer shpirtin, të largojmë gjithçka që na ndalon të arrijmë paqen e vërtetë dhe të kthehemi në një gjendje të përpjekjes për përsosmëri”, tha ndër të tjera kreu i KMSH-së.

Komuniteti Mysliman e ka kthyer në traditë shtrimin e iftarit të parë të Ramazanit. Nëpërmjet kësaj tryeze, institucioni i myslimanëve shqiptarë bashkon figura të rëndësishme të jetës publike, të cilët vijnë për të nderuar e respektuar sakrificën e myslimanëve në muajin më të rëndësishëm të kalendarit islam.



02 ZHVILLOHET KONFERENCA NDËRKOMBËTARE: “NDËRTIMI I URAVE NDËRMJET MEDHHEBEVE DHE SEKTEVE” E ORGANIZUAR NGA LIGA BOTËRORE ISLAME (RABITA)



Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, merr pjesë në edicionin e dytë të Konferencës Ndërkombëtare “Ndërtimi i urave ndërmjet medhhebeve dhe sekteve” të organizuar nga Liga Botërore Islame (RABITA), nën kujdesin e Kujdestarit të Dy Xhamive të Shenjta, Mbretit Selman bin Abdulaziz al Saud, në Mekë, Arabinë Saudite.

Ky takim i rëndësishëm ka mbledhur mbi 500 delegatë, dijetarë të njohur nga bota islame, drejtues fetarë, myftinj, ministra dhe intelektualë nga më shumë se 90 vende, të cilët diskutuan rrugët për forcimin e unitetit mes myslimanëve.

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ishte pjesë e sesionit hapës të edicionit të dytë të Konferencës, një moment kyç ku u përcollën mesazhe unifikuese nga personalitetet më të larta fetare dhe intelektuale të botës islame, përfshi Sekretarin e Përgjithshëm të Ligës Botërore Islame, Dr. Muhamed Abdulkerim el Isa.

Gjatë këtij sesioni, ai përshëndeti Konferencën dhe mbajti një fjalim, ku theksoi rëndësinë e dialogut dhe bashkëpunimit si mjete thelbësore për të shmangur përçarjet dhe për të ruajtur unitetin e myslimanëve.



03 AMBASADORI I EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE VIZITON KMSH-NË



Ditën e djeshme, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, së bashku me përfaqësues të tjerë të institucionit, pritën në një takim z. Ali Al Dhaeri, Ambasador i Emirateve të Bashkuara Arabe me seli në Athinë por që mbulon njëkohësisht edhe vendin tonë.

Pasi i uroi mirëseardhjen, Kryetari Spahiu e njohu Ambasadorin shkurtimisht me organizimin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, duke theksuar rëndësinë e mbarëvajtjes së aktivitetit fetar, si dhe angazhimin për promovimin e vlerave themelore të Islamit, që përqendrohen në paqe, dashuri dhe respekt për të tjerët.

Ndërkohë, Ambasadori vlerësoi rolin e Komunitetit Mysliman për angazhimin e tij në ruajtjen e stabilitetit ndërfetar dhe atij social, duke kontribuar në krijimin e një ambienti ku harmonia dhe mirëkuptimi janë elemente kyç për një shoqëri të qëndrueshme dhe të zhvilluar.

Bashkëbisedimi ndërmjet palëve vijoi më tej në fusha me interes të përbashkët, duke parë mundësitë për të forcuar bashkëpunimin në të ardhmen, me synimin për të promovuar vlerat e përbashkëta dhe nismat me ndikim pozitiv në shoqëri.



04 E NGARKUARA ME PUNË E AMBASADËS SË SHBA-SË NË TIRANË VIZITON KMSH-NË



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një takim kortezie në selinë e institucionit të Ngarkuarën me Punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, znj. Nancy VanHorn.

Gjatë bashkëbisedimit, kryetari Spahiu pasi i uroi mirëseardhjen dhe suksese në këtë detyrë, vlerësoi marrëdhëniet e mira dypalëshe mes Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Ambasadës së SHBA-ve. Ai gjithashtu e njohu znj. VanHorn me historinë, organizimin, institucionet arsimore, misionin e institucionit, si dhe rolin e tij në ruajtjen e harmonisë dhe dialogut ndërfeetar në Shqipëri.

Nga ana e saj, znj. VanHorn shprehu kënaqësinë për këtë takim dhe vlerësoi leadershipin dhe rolin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në shoqëri si dhe angazhimin e tij në promovimin e vlerave të tolerancës dhe bashkëjetesës fetare. Ajo vlerësoi marrëdhënien mjaft pozitive që ka karakterizuar të dy institucionet ndër vite.

Takimi u zhvillua në një atmosferë miqësore dhe bashkëpunuese, ku u diskutua mbi tematika të ndryshme të karakterit fetar, social e kulturor që prekin aktualitetin e vendit tonë, duke shërbyer si një mundësi e mirë për të forcuar më tej marrëdhëniet mes dy institucioneve.



05 MIJËRA BESIMTARË MYSLIMANË TË KRYEQYTETIT DHE JO VETËM, FESTOJNË FITËR BAJRAMIN



Mijëra besimtarë myslimanë të kryeqytetit dhe jo vetëm, falën sot namazin e Fitër Bajramit në sheshin "Skënderbej" në Tiranë dhe mijëra të tjerë u tubuan në sheshet dhe xhamitë kryesore të çdo qyteti tjetër të vendit tonë, duke festuar kështu përfundimin me sukses të një muaji maratonë në aspektin e adhurimeve.

Programi i Fitër Bajramit në shesh filloi që në orët e para të mëngjesit me leximin e disa ajeteve nga Kur'ani Famëlartë, të cilat u përcollën për besimtarët e pranishëm nga Myftiu i Tiranës, z. Gazment Teqja.

Fill pas leximit të Kuranit Fisnik, ishte radha e fjalës përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili përcolli mesazhe të ngrohja urimi, paqeje dhe mirëkuptimi.

Programi i Fitër Bajramit vijoi me ligjëratën e rastit të mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm i Ligës Botërore Islame, Dr. Muhamed Bin Abdulkerim El-Isa, i cili iu drejtua mijëra besimtarëve të pranishëm me mesazhe të frymëzuara nga muaji i bekuar i Ramazanit.

Programi kulmoi me faljen e namazit të Fitër Bajramit, ku mijëra besimtarët e mbledhur në shesh i priu Sekretari i Përgjithshëm i Ligës Botërore Islame, Dr. Muhamed Bin Abdulkerim El-Isa, për të vazhduar më pas me hutben e Bajramit, e cila u mbajt po ashtu nga ai.

Me lutje të sinqerta, ai kërkoi që paqja, harmonia dhe solidariteti të mbizotërojnë mes besimtarëve dhe mbarë njerëzimit, duke e bërë botën një vend më të drejtë dhe më të begatë për të gjithë.

Më pas besimtarët e pranishëm në shesh u shpërndanë për të festuar me familjet dhe të afërmit e tyre.



06 PERSONALITETE DHE PËRFAQËSUES INSTITUCIONESH UROJNË BESIMTARËT PËR FITËR BAJRAM



Haxhi

PËRMES HISTORISË DHE PËRJETIMIT



Pelegrin konsiderohet personi që viziton disa vende të shenjta për qëllime fetare. Peligrinazhi për në vendet e shenjta është një rit i zakonshëm që shfaqet thuajse në të gjitha komunitetet fetare. Ai ka qënë tipari karakteristik për shumë religjione, që nga Egjipti, Persia, India, Japonia dhe Kina e lashtë.

Pelegrinazhi është një manifestim shpirtëror i qenies njerezore në kërkim të ngushëllimit përfundimtar. Është udhëtimi i pelegrinëve në kërkim të Krijuesit të tyre. Pelegrini ia drejton të gjitha dëshirat dhe kërkesat Zotit të tij dhe kërkon mëshirë e falje për gjynahet e së shkuarës. Ai do t'i tregojë Zotit se është i singertë në qëllimin e tij, nëpërmjet kryerjes së riteve dhe bërjes së sa më shumë sakrificave, që janë përgjithësisht pjesa thelbësore e peligrinazhit (përfshirë këtu të gjitha fetë). Në rastet më të shumta, pelegrinët mbërrijnë në destinacion pas kryerjes së një udhëtimi të gjatë dhe të lodhshëm, udhëtim që kryhet nëpërmjet kursimeve të përfuara nga puna e tyre gjatë gjithë jetës.

Konstatohet lehtë se peligrinazhet dhe ritet përkatëse vihen re thuajse në të gjitha fetë, por vlen për t'u theksuar fakti se pjesa më e madhe e ritualeve kanë shumë gjëra të përbashkëta. Kjo ngjashmëri lyp një studim të thellë e të kujdesshëm në praktikën e peligrinazheve. Megjithatë, si për të filluar këtë konstatim, le t'i kushtojmë vëmendje pikave të mëposhtme:

Komunitete të besimeve të ndryshme nga vende të ndryshme të botës, ruajnë praktika të njëjta fetare edhe pse supozohet se e kanë zanafillën në etapa të veçanta të historisë.

Në kohët e lashta, transporti dhe komunikacioni ishin tepër të vështirë e në disa raste edhe të pamundura. Megjithatë, kishte tipare të përbashkëta që mund të dilnin në pah në ritualet e peligrinazheve nga komunitetet të ndryshme, që banonin në vende të ndryshme të botës.

Asnjë prej këtyre komuniteteve nuk e ruan ritualin në përgjigje të urdhrave të profetëve të tyre. Nëse do të ishte kështu, procedurat e ritualeve duhet të



kishin qenë të ndryshëm njëri nga tjetri.

Këto ngjashmëri të çuditshme nuk janë aspak aksidentale apo të rastit dhe për më tepër, nuk janë kryer si pasojë e riprodhimit të ritualeve nga një vend në tjetrin. Krijuesi dhe Mbrojtësi i botës, i Gjithëfuqishmi Allah, na e sqaron këtë në Kur'an:

"Secilit popull ne i dhamë ligj që ata veprojnë sipas tij, pra le të polemizojë me ty për këtë çështje e ti thirrri te Zoti yt se, pa dyshim, ti je në një rrugë të drejtë." (22:67)

Ajeti kuranor e shtyn njeriun të mendojë rreth motivit të pelegrinazhit në të gjitha komunitetet. Le të nxjerrim në pah të përbashkëtat e ritualeve të pelegrinazheve kudo në botë:

1. Psalmet dhe këngët e hindusët dhe budistët.
2. Këndimi i hymneve nga kristianët dhe bërja dhikër nga pelegrinët myslimanë.
3. Lutjet e vazhdueshme ndaj Zotit të Gjithëfuqishëm gjatë periudhës së pelegrinazhit.
4. Sakrifikimi i kafshës nga myslimanët dhe sakrifikimi simbolik të kristianët dhe hebrenjtë.

5. Rruajtja e kokës të myslimanët dhe të disa sekte hinduse.

6. Rregulli i veshjes së veçantë në këtë rast të spikatur, të myslimanët dhe hindusët.

7. Ardhja qark vendeve të adhurimit të myslimanët dhe hindusët.

Duket qartë se këto rituale janë në thelb të njëjta në të gjitha fetë, ndonëse në formë dhe mënyra të ndryshme. Kur'ani e shpjegon këtë fakt në një ajet tjerër: **"Ne i kemi përcaktuar çdo popull vendtherrjen (e kurbanit) që ta përmendin emrin e Allahut për arsye se i furnizoi ata me kafshë. Zoti juaj është Një Zot, andaj vetëm Atij dorëzohuni e përgëzoi të dëgjueshmit."** (22-34)

Në dy ajetet e cituara (22.34 dhe 22.67) fjala në arabisht Manasik përdoret për ceremoni fetare të ndërthurrura me pelegrinazhin e Haxhit. Është për t'u marrë në konsideratë fakti se fjala Manasik nënkupton në të njëjtën kohë edhe "sakrificë fetare". Kështu, është më se e qartë se është vetë Zoti i Gjithëfuqishëm, i Cili përshkruan ritualet për të



gjitha komunitetet. Me fjalë të tjera, pelegrinazhi është një nga përshkrimet e Allahut, që provon mëshirën dhe dashurinë e Tij për të gjitha krijesat, pa asnjë lloj paragjykimi në funksion të racës, besimit, gjuhës, ngjyrës, etj. Pelegrinazhi gjithashtu nxjerr në pah Njësimin e Zotit dhe begatinë e dashurisë së Tij për të gjithë njerëzimin dhe krijesat. Fakti i pakundërshtueshëm se ky ritual ruhet në tërësi me ngjashmëritë dhe diferencat midis komuniteteve të ndryshme kudo në botë, provon se e ka origjinën te Zoti i Vetëm. Ajo që mbetet për t'u hetuar është se "si" dhe "pse" ndryshimet nxorren kokë në këto besime me kalimin e kohës.

Pelegrinazhi në Islam

Midis të gjitha llojeve të pelegrinazheve, Haxhi është i vetmi, për faktin se pelegrinët vizitojnë vendin e shenjtë, Qaben, në përgjigje të ftesës së Zotit. Myslimanët besojnë se Allahu e ftoi gjithë njerëzimin nëpërmjet profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të). Kjo ftesë hyjnore përmendet në Kur'an:

"Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë dhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta."

"Pastaj le të heqin papastërtinë e tyre, le t'i zbatojnë

premtimet e veta dhe le të sillen rreth shtëpisë së lashtë." (22:27-29)

Pra, ftesa e drejtpërdrejtë ndaj gjithë njerëzimit është përhapur për herë të parë nga profeti Ibrahim, i cili ka jetuar mijëra vjet të shkuar. Ftesa e Allahut është përhapur në kombe të ndryshme që shtrihen anembanë botës, përmes profetëve nga gjiri i tyre. Përfundimisht, ishte profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të), i cili u urdhërua të ftojë gjithë njerëzimin. Sidoqoftë, në periudhën e fundit, një mori kombesh kanë humbur rrugën e drejtë nga pasaktësitë e klerikëve të tyre. Të nxitur nga përfitime materiale, ata i kanë bërë njerëzit të besojnë se profetët dhe disa njerëz të mëdhenj të fesë ishin gjysmëzot. Hyjnorja iu atribua profetëve. Për pasojë, varrezat e tyre u shndërruan në vende pelegrinazhi.

Këto vende pelegrinazhesh dhe ritualesh njerëzore, që spikasin tani në fe të tjera, kanë evoluar në kohë prej një formati origjinal, që ishte padyshim krejt ndryshe nga formatimet e shumta që gjejmë sot. Ndërhyrja e kohëpaskohshme e priftërinjve dhe mbretërve, ndryshoi destinacionin origjinal të pelegrinazhit të përshkruar nga Allahu, në destinacione njerëzore.



Për pasojë, forma origjinale e pelegrinazhit ndryshoi dhe risitë dolën në sipërfaqe. Edhe në ditët e sotme vazhdojnë ritmet galopante të rritjes së numrit fiktiv të destinacioneve njerëzore të pelegrinazheve. Por Meka, si një destinacion pelegrinazhi, është padyshim krejt ndryshe nga vendet e tjera, për shkak të disa arsyeve:

Së pari, varri i profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të) është në Medine dhe jo në Mekë, ndërkohë që Medina nuk është vend i caktuar për pelegrinazhin e Haxhit. Në fakt, profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) ka qenë tejet i kujdesshëm për të mos lënë asnjë mundësi që varri i tij të bëhej vend adhurimi. Ai druhej se i njëjti fat i profetëve të mëparshëm do të binte edhe mbi umetin e vet. Ky mendim e bëri profetin që edhe në momentet e fundit të jetës, t'i kushtonte shumë rëndësi këtij fakti, madje edhe në shtratin e vdekjes, siç na bën me dije Aishja dhe Ibn Abas, çka transmetohet nga Imam Buhariu.

Së dyti, bërja e vizitave në varret e njerëzve të mëdhenj, përfshirë këtu edhe profetët, nuk është pjesë e pelegrinazhit në Islam. Asnjë varr profeti nuk është venduar në afërsi të Qabes, Minasë, Arafatit apo Muzdelifes, vende në të cilat qëndrojnë pelegrinët gjatë periudhës së Haxhit. Pelegrinët vizitojnë varrin e

profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të) dhe shokëve të tij në Medine, por kjo nuk është pjesë e pelegrinazhit. Pelegrinët, duke ardhur nga vende të ndryshme të botës, e shohin si një rast të rrallë mundësinë për të vizituar Xhaminë e Profetit (paqja qoftë mbi të) gjatë kohës së haxhit. Ata nuk duan që t'u ikë nga dora ky shans unikal. Përveç kësaj, ajo është xhamia e dytë më e rëndësishme për myslimanët. S'ka asnjë fakt tjetër që i bën myslimanët të vizitojnë xhaminë e Profetit në Medine.

Përmbledhtazi, asnjë mysliman i vetëdijshëm nuk e konsideron vizitën në Xhaminë e Profetit apo në varrin e tij, si pjesë e pelegrinazhit. Kështu, në ndryshim nga fetë e tjera, Meka është bërë destinacioni i pelegrinazhit për vetë faktin se Qabeja (faltorja e parë në botë për të adhuruar Allahun ndërtuar nga profeti Ibrahim) ndodhet pikërisht atje.

Ftesa hyjnore

Së treti, në kontrast të plotë me pasuesit e feve të tjera, myslimanët kryejnë pelegrinazhin në përgjigje të ftesës së lashtë e mijëra vjeçare të Allahut. Ata e konsiderojnë veten si bujtës të Allahut në Mekë dhe njëkohshëm, nëpërmjet Kur'anit dhe Profetit (paqja

qoftë mbi të) konturimi i haxhit është kryer nga Allahu për gjithë njerëzimin. E për rrjedhojë, myslimanët e ndjekin edhe sot rigorozisht këtë akt thelbësor. Pelegrinazhi i kryer nga Profeti Ibrahim mijëra vjet më parë, i kryer nga Profeti Muhamed 1400 vjet më parë dhe pelegrinazhi i kryer nga myslimanët në kohët e sotme, janë një dhe të pandarë. Të njëjtat rite, i njëjti kod veshjeje e kështu me radhë. Nuk është bërë asnjëherë ndryshim në formë dhe përmbajtje. Nuk mund të gjendet në asnjë fe tjetër, një ruajtje kaq aktive dhe e pastër, duke sfiduar devijimet në kohë dhe ndërhyrjet klerikale. Ajetet kuranore, që i referohen kësaj ftese të bërë nga Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të), u zbritën ndërkohë që Qabja ishte nën kontrollin e jomyslimanëve.

Është e pabesueshme që një udhëheqës vendi të urdhëronte pasuesit e tij të kryenin pelegrinazhin në Mekë, e cila ishte nën kontrollin e armiqve të tij deklaruar, të cilët mezi ç'prisnin rastin t'i dëbonin myslimanët.

Myslimanët ishin shumë të dhënë në ndjekje të sunetit të Profetit Muhamed a.s. qoftë në jetën e tyre, qoftë edhe në të gjitha hallkat e jetës së përditshme. Shokët e tij vëzhgonin qoftë edhe lëvizjen apo reagimin më të vogël të Profetit dhe nuk linin që fjala e tij të binte në tokë, por në çast e vinin në zbatim në jetën e tyre e në raste të tjera, e ruanin fort në kujtesë për ta vënë në zbatim kur ta lypte nevoja. Profeti Muhamed a.s. ishte shumë i ndërgjegjshëm mbi këtë fakt. Ai e dinte se në vitet në vijim pelegrinët do të përpqeshin fort ta kryenin Haxhin sipas shembullit të tij. Ai druhej se qoftë edhe një fjalë apo lëvizje e kryer jashtë rritit, do të shihej nga pasuesit e tij si pjesë e rregullave të Haxhit. Kështu, gjatë kohës së kryerjes së Haxhit të parë dhe të vetëm prej tij (Haxhi i Lamtumirës), ai ishte tejet i kujdesshëm në secilin prej riteve që kryente dhe në çdo hap që hidhte. Duket qartë se çdo gjë që Profeti bëri në respekt të Haxhit, nuk ishte gjë tjetër veçse një ripërtëritje e riteve origjinale të monoteizmit, duke mënjeluar zakonet pagane që depërtuan me kalimin e kohës. Ai riktheu në zbatim Ditën e Arafatit, e cila ishte anashkaluar dhe për pasojë edhe mënjeluar nga rituali i Haxhit prej pelegrinëve paganë. Përkundrazi, Profeti urdhëroi ndjekësit e tij ta kalonin natën në Muzdelife duke u falur dhe pushuar. Ai gjithashtu ndaloi therrjen e kafshëve përballë idhujve në Qabe. Në vend të saj, ai rivendosi rregullin që sakrificimi i kafshëve të kryhej në shesh të hapur në Mina, si një simbol i nënshtrimit tërësor ndaj vullnetit të Allahut. Edhe pse kanë kaluar mbi 14 shekuj, pelegrinët myslimanë i kryejnë këto rite pa asnjë ndryshim apo devijim.

Haxhi: Një mrekulli

Duke u bazuar në transmetimet profetike, ishin mëse 30.000 haxhilerë që e shoqëronin Profetin Muhamed a.s. në udhëtimin e tij nga Medina. Ndërkohë që në Mekë kishin mbërritur afro 100.000 të tjerë nga

vende të ndryshme, për të kryer haxhin me Profetin. Në ditët e sotme, më shumë se 5-6 milionë haxhilerë mbërrijnë çdo vit në Mekë. Një mori mjetesh transporti me pelegrinë arrijnë në Mekë, ditë përpara se të nisin ditët e Haxhit. Rreth 49.000 metër katror sipërfaqe vihet në dispozicion të parkimit të automjeteve. Qindra e mijëra policë janë në detyrë në çdo orë të ditës për të vënë rregull në mjetet e transportit, qysh nga makinat luksoze, mikrobuzët, autobuzët, etj. Kjo panoramë na sjell ndër mend ajetin kuranor që flet për këtë masë të madhe e të mahnitshme mjetesh transporti e njerëzish:

“Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta. (vijnë) Për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin Allahun në ato ditë të caktuara (në shenjë falënderimi) dhe për atë që i ka furnizuar me kafshë. Hani pra prej tyre (kurbanëve) dhe ushqeni të ngushtuarin e të varfrin.” (22: 27-28)

Në fakt, ky ajet kuranor, megjithë ngjyrimet dhe larminë e kuptimeve të fjalëve të përdorura në të, nxjerr në pah faktin e hyjnore në Kur'an. Sensi, shpirti dhe profecia e ngërthyer në këtë ajet, është një dëshmi e qartë për këdo që sheh një fluks prej miliona njerëzish nga vende të ndryshme të botës, që tubohen në mes të shkretëtirës. Këto lloj urdhërash me fuqi zbatimi që mobilizojnë njëkohshëm miliona njerëz, e kanë origjinën vetëm në burim hyjnor, sepse përndryshe askush nuk do të merrte një udhëtim të gjatë e të lodhshëm drejt Qabes. Fuqia e pakrahueshme e këtij ajeti mund të konstatohet edhe nga çdo njeri me gjykim mesatar, i cili mund të dëshmojë ngjarjen madhështore në fjalë, Haxhin. Historia njerëzore nuk sjell dot në kujtesë një ngjarje tjetër, e cila mund të krahasohet me këtë ngjarje madhështore që kryhet vit pas viti. Pelegrini që viziton Mekën është miku dhe i ftuari i Allahut. Feja e tij varet në fije të perit për disa arsye, pasi atij i duhet të kalojë provën e besimit, për të njohur realisht veten e tij.

“Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre por tek Ai arrin bindja juaj. Ai ashtu ua nënshtroi ato juve që ta madhëroni Allahun për udhëzimet që ua bëri. Bamirësve merru myzhde.” (22: 37)

Profeti Muhamed a.s. i këshillonte myslimanët të kujdeseshin që asnjë gjurmë politeizmi mos të shfaqej gjatë periudhës së kryerjes së riteve të Haxhit. Në mënyrë fort të habitshme, zakonet dhe risitë që shtrajnë udhën drejt politeizmit janë eliminuar totalisht, nëse do të marrim në konsideratë udhëzimet e tij

Shekuj e shekuj para profetit Muhamed a.s., profetët Ibrahim dhe Ismail (paqja qoftë mbi ta) i kryen këto rite nën urdhrat e të Gjithëfuqishmit Allah. Profeti Muhamed a.s. ndoqi të njëjtat rite me të njëjtën radhitje. Tani, 14 shekujsh, miliona myslimanë mbërrijnë çdo vit në Mekë dhe kryejnë të njëjtin ritual, pa cenuar as formën dhe as përmbajtjen e tij.



HAXHI DHE KURBANI

DISA PYETJE DHE PËRGJIGJE

1- A është Haxhi një rit pagan?

Disa prej jo-muslimanëve piren t'ia mbushin mendjen vetes se Haxhi është një rit i pastër pagan apo një formë e idhujtarisë. Ky hamendësim ka qenë praktikuar nga idhujtarët arabë përpara Islamit, dhe që Islami e fshiu nga faqja e dheut. Ky hamendësim mbështetej në faktin se Qabja ka qenë vendi ku strehoheshin së paku 360 idhuj. Sidoqoftë, kjo është përjasje mashtroze e fakteve dhe e të dhënave. Pasi nuk kanë qenë idhujtarët e Mekës, por profeti Ibrahim (paqja qoftë mbi të!) që nisi veprimtarinë e Haxhit qysh asaj kohe. Në të kundërt, ishin pikërisht pasardhësit e Ibrahimit dhe Ismailit (paqja qoftë mbi ta!) që e shndërruan Qaben e Shenjtë të Allahut, në një panteon vigan.

Ishte pikërisht kjo radhë idhujtarësh që futi ritet pagane në pelegrinazhin e pastër islam. Nderimet e bekimet i takojnë Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të!), vulës së profetëve dhe të fundit të linjës së profetëve që zë fill me Ibrahimin (paqja qoftë mbi të!), që ishte i pari që e mbajti të pastër Qaben nga zotat.

Në fakt, muslimanët janë ndjekësit e vërtetë të besimit të profetit Ibrahim dhe vulës së profetëve, profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të!), pasi Haxhi në Mekë është një trashëgimi e vlefshme, ashtu si dhe një shtyllë e besimit.

2- A çlirohet dikush nga detyrimi i adhurimeve që janë farz ose vaxhib nëse nuk i kryen vetë këto, por cakton si përfaqësues (vekil) një tjetër që t'i kryejë në emër të tij?

Për sa u përket namazit dhe agjërit, si adhurime që kryhen vetëm fizikisht, caktimi i përfaqësuesit, në mënyrë absolute, nuk lejohet. Askush nuk mund të falë namaz apo të agjërojë në vend të dikujt tjetër. Kryerja me përfaqësim e adhurimeve që duhen kryer fizikisht, nuk e çliron individin nga përgjegjësia e kryerjes së tyre.

Për sa u përket obligimeve si zekati, sadakaja

apo kurban, të cilat kryhen me mall, caktimi i një përfaqësuesi është absolutisht i lejuar. Dikush, sikurse mund t'i japë vetë zekatin apo sadakanë dhe të thërë kurbanin, mund t'i kryejë këto edhe nëpërmjet dikujt tjetër.

Për sa i përket Haxhit, që kryhet edhe fizikisht, edhe me pasuri, për dikë që është i përgjegjshëm, por që nuk i ka mundësitë fizike për ta kryer vetë, lejohet që të caktojë përfaqësues dikë tjetër. Në të kundërt, caktimi i përfaqësuesit nuk është i lejuar.

Nëse për arsye si vdekja, mosha e madhe, lëngatat e gjata, mosgjendja e personave të përshtatshëm për të shoqëruar gratë në udhëtim, nuk janë mundësitë e kryerjes së Haxhit, dikush tjetër mund të dërgohet përfaqësues në emër të personave që kanë arsyet në fjalë. Ata që e kanë Haxhin obligim dhe që nuk mund ta kryejnë atë për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, duhet të dërgojnë një përfaqësues (vekil) për të bërë Haxhin e tyre.

Ata që, megjithëse e kanë Haxhin obligim, as nuk mund të shkojnë vetë dhe as nuk mund të dërgojnë përfaqësues, përpara vdekjes duhet të lënë porosi testamentare që dikush të bëjë Haxhin në emër të tyre.

Në lidhje me kryerjen e Haxhit me përfaqësues, një hadith i transmetuar nga Abdullah b. Abbasi e ndriçon çështjen si vijon: *"Një grua prej fisit Hasa, në vitin e Haxhit të Lamtumirës, shkoi tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, dhe e pyeti: "O i Dërguari i Allahut! Urdhri i Zotit të Madhëruar që njerëzit të kryejnë Haxhin, babait tim i mbërriti në një moshë shumë të thyer, aq sa s'mund të qëndronte mbi kafshë. Nëse unë bëj haxh në emër të tij, a i shlyhet borxhi?" / Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, iu përgjigj: "Po, i shlyhet."* (Buhari, Haxh, 1,2; Muslim, Haxh, 7/3).

3- Cila është historia e Gurit të Zi?

Më shumë se pesë mijë vjet më parë, babai i profetëve, Ibrahim (paqja qoftë mbi të!) ndërtoi Qaben duke përbushur urdhrin e Allahut. Ai (paqja qoftë mbi të!) e ndërtoi edhe me ndihmën e djalit të tij më të vogël, Ismailit. Ja se si përshkruhet në Kur'an ndërtimi i Qabes:

“Edhe kur Ibrahim dhe Ismaili duke i ngritur themelet e shtëpisë (Qabes, luteshin): “Zoti ynë, prano prej nesh se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di!”

Babai dhe djali, besimtarë të sinqertë të Zotit Një, po përpqeshin ta ndërtonin me zemër të ngrirë (për myslimanët kjo është shkalla më e lartë e përkushtimit, pasi frika dhe droja shprehin besimin e pastër te Allahu). Ata kishin droje se Allahu nuk do t'ua pranonte shërbesën e tyre të përvuajtur. Ky është thelbi i monoteizmit, një shembull që duhet ndjekur nga të gjithë myslimanët. Kur ndërtesa kishte shkuar gjer në një farë lartësie, Ibrahim (paqja qoftë mbi të!) i kërkoi të birit një copë gur për të shënjuar cepin e ndërtesës. Ndërkohë që i biri po kërkonte gurin, kryeengjëlli Xhibril u shfaq me një gur nga Xheneti.

Ibrahim (paqja qoftë mbi të!) e mori gurin dhe e vuri në vendin e duhur, dhe i tillë qëndron atje sot e kësaj dite. Është një gur qiellor, nuk është aspak gur tokësor. U zgjodh prej Allahut për Shtëpinë e Tij të Shenjtë (Qaben).

4- A është puthja e Gurit të Zi aq thelbësore?

Dihet mirë procedura e bërjes së tavafit, që konsiston në rënien qark të Qabes për shtatë herë rresht. Çdo rrotullim nis nga cepi i Qabes, ku është vendosur Guri i Zi. Kjo mund të dallohet nga cilido haxhi që viziton Xhaminë e Shenjtë, edhe sikur ta ketë për herë të parë.

Le të mos harrojmë se mijëra apo dhjetëra mijëra njerëz ka raste, që i bien rreth Qabes në të njëjtën kohë. Jo vetëm që është e pamundur për cilindo të pranishëm të puthë apo të prekë Gurin e Zi, madje ka raste që edhe nuk mund ta shohësh dot gurin, për shkak të distancës që të krijohet me të. Është më se normale që në këto raste të mbetet vetëm të kthehesh nga cepi verilindor i ndërtesës, dhe një zgjatje dore për nga Guri i Zi, në formë përhëndetje, është një veprim më se i mjaftueshëm.

5- A theret kurban për të vdekurit?

Nëse dikush dëshiron që të therë kurban me qëllimin që sevapi i therjes së tij t'i shkojë një personi të dashur a të afërt që ka vdekur, mund ta bëjë këtë. Ashtu sikurse në emër të një njeriu të vdekur mund të jepet pas vdekjes sadaka apo të bëhet haxh, mund të theret edhe kurban në emër të tij. Kështu, Profeti ynë ka therur kurban në emër të njerëzve nga umeti i tij që nuk mund të therrnin kurban. (Taberani, Muxhemu'l-Kebir, 3/182; Hejthem, Mexhmau'z-Zevaid, 4/23)

Në Sunenin e Ebu Davudit, nën titullin përmbljedhës “Therja e kurbanit pas vdekjes së dikujt”, shënohet:

‘Aliu (r.a.) therte dy desh, ndër të cilët njërin për Profetin. Kur e pyetën për këtë, tha: ‘I Dërguari i Allahut më ka lënë amanet që të ther kurban për të sa të jem

gjallë. Kurrsesi nuk e lë pa bërë këtë.’ (Ebu Davud, Edahi, 1; Hakim, Mustedrek, 4/255).

Fakti se Profeti ynë i ka lënë porosi Aliut (r.a.) që të therë kurban në emër të tij është argument që një gjë e tillë lejohet. Për këtë arsye, ata që kanë mundësi çdo vit mund të therin si kurban në emër të Profetit tonë të dashur së paku një dele/dash ose të marrin pjesë në një të shtatën e një kurbanit lopë. Kjo do të ishte një sjellje plotësisht e pranueshme dhe me vend.

Nëse dikush, me të hollat që fiton vetë, ther një kurban për t'i dhuruar sevapin një të afërmi të vdekur, nga mishi i atij kurbanit mund të ushqehet edhe vetë, sikurse t'i dhurojë edhe të tjerëve. Gjithashtu, nuk është kusht një kurban me këtë nijet të theret vetëm në ditën e Bajramit. Mund të theret në çdo kohë. Nëse theret dhe u shpërndahet të varfërve në ditën e Arafatit, është edhe më mirë, pasi në ditën e Bajramit të Kurbanit, sido që të jetë, të varfërve do t'u shpërndahet mish. Nëse theret dhe shpërndahet në ditën e Arafatit, kjo mundëson që ata të ushqehen me mish edhe atë ditë.

Nëse dikush që është ndarë nga jeta ka lënë porosi testamentare qysh më parë që të theret kurban në emër të tij, atëherë ky kurban duhet të theret në ditët e Bajramit. Prej këtij mishi nuk mund të hajë askush nga familja apo të afërmit, por duhet dhënë i gjithi për sadaka. Edhe nëse personi i ndarë nga jeta nuk ka lënë ndonjë porosi, por nga të hollat e lëna prej tij theret kurban, veprohet njëlloj si në rastin e kurbanit për të cilin është lënë porosi. Edhe në mos pastë porosi testamentare apo betim (nedhr), sipas shumicës së juristëve myslimanë, me përjashtim të shafive, mund të theret kurban në emër të tij, me qëllimin për t'i dhuruar të vdekurit sevapin përkatës.

6- A mund të jepet sadaka në vend të therjes së kurbanit?

Çdo adhurim ka vendin e vet. Zekati ka vendin e vet, sadakaja të vetin dhe kurbanit të vetin. Sidoqoftë, nëse në ditët e Kurban Bajramit, kur theret kurban, nuk është arritur të theret kafsha e caktuar për këtë, atëherë ajo jepet sadaka në qoftë e gjallë ose dhurohet si sadaka vlere e saj nëse kafsha ka ngordhur. Adhurimet financiare që kryhen për afrim ndaj Allahut (kurbijet) janë dy lloje: një pjesë e tyre, si sadakaja apo zekati, i dhurohen tjetrit në dorë; ndërsa pjesa tjetër është në formën e nxjerrjes nga duart, të sakrifkimit, si në rastin e lirim të skllervëve dikur. Në rastin e kurbanit, janë të dyja. Kurbanit e siguron afrimin tek Allahu fillimisht duke therur kafshën, çka, si sakrifkim, hyn në llojin e dytë. Më pas mishi dhurohet si sadaka dhe kjo është dhurim i llojit të parë. Por ajo që mbetet thelbësore është therja e kurbanit për hir të Allahut. Nëse kjo nuk bëhet, detyrimi i kurbanit nuk është çuar në vend. Për këtë arsye, në ditët e Bajramit të Kurbanit me dhënien e të hollave në vend të therjes së kurbanit, obligimi nuk është çuar në vend.

NAMAZI DHE GRUAJA MYSLIMANE NJË LIDHJE QË I JEP SHPIRT JETËS

Namazi është udhëtimi më i bukur shpirtëror i një besimtarit dhe kulmi i lidhjes së tij me Krijuesin. Në një botë që lëkundet çdo ditë me ritme të vrullshme, namazi është çasti ku gjejmë qetësinë e vërtetë. Për gruan myslimane, kjo lidhje merr ngjyra të veçanta: është përqafim, mburojë, frymëzim, forcë. Edhe kur bota e vendos para sfidave të shumta, edhe kur pesha e roleve të saj është e rëndë, ajo mbetet e lidhur me sexhden si një fije drite që nuk këputet kurrë.

Allahu i Madhëruar thotë:

“...Me të vërtetë, namazi ndalon nga të këqijat dhe të shëmtuarat...” (El-Ankebut, 45)

Ky ajet është premtim dhe ngushëllim se namazi është mbrojtje, është rregullues i brendshëm që na ndihmon të qëndrojmë të pastër shpirtërisht, edhe kur jeta na sfidon.

Megjithatë, shumë gra e përjetojnë namazin me ndienjën e pamjaftueshmërisë. Disa ndihen të lodhura nga detyrimet, të tjera të pasigurta për shkak të mungesës së dijeve, ndërsa disa të lëkundura nga gjykimet e njerëzve. Ka gra që mendojnë se namazi kërkon një “perfeksion” që ato nuk e përmbushin dot. Por Islami na mëson se namazi nuk është për të përsosurit, por për ata që e kërkojnë Zotin – nëse zemra qan për t’u kthyer, Allahu është më afër se sa e imagjinojmë.

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ka thënë:

“Më i dashuri i veprave të Allahut është namazi në kohën e vet.” (Buhariu dhe Muslimi)

Kjo thënie na kujton se nuk ka rëndësi vetëm të falem, por të përpiqemi që ta përjetojmë atë në kohën e duhur, në mënyrën më të sigurtë që mundemi. Dhe kjo përpjekje është e çmuar tek Allahu.

Femra në Islam është e nderuar në

çdo gjendje dhe namazi i saj i pranohet edhe kur është vetëm, edhe kur është e zënë me fëmijët, edhe kur nuk ka kohë për përkushtim të gjatë. Ajo nuk ka nevojë të jetë si dikush tjetër, por të jetë vetvetja në përpjekje për t’iu afruar Zotit. Sepse Allahu e do përpjekjen, jo vetëm përfundimin. Një nënë që falet mes lodhjes dhe përgjegjësisë të përditshme, një grua që gjen kohë për Allahun në mes të angazhimeve të jetës, një vajzë që ruan namazin në kohëra kur të tjerët e braktisin, janë të gjitha heroinat e padukshme të kësaj feje.

Namazi nuk është vetëm obligim, ai është frymëmarrje. Është mënyra me të cilën gruaja e pastrohet shpirtin, e rregullon jetën, e mban afër mëshirës së Zotit. Ai nuk është një pengesë, por një liri e thellë. Në sexhde ajo nuk gjunjëzohet për t’iu nënshtruar burrit, shoqërisë apo rrethanave, por për t’u ngritur shpirtërisht përtej gjithçkaje.

Përmbyllje

O motër, kthehu te namazi si fëmija që kthehet në përqafimin e nënës: pa frikë, pa turp, me gjithë zemër. Çdo herë që bie në sexhde, mos mendo për mungesat e tua, por për mëshirën e Atij që të pret. Loti yt në sexhde nuk është dobësi, por forcë. Përpjekja jote për t’u falur, edhe në rrëmujën e jetës, është dashuri. Namazi yt është ura që të lidh me Zotin kur të gjithë të tjerët heshtin. Mos e humb. Mbaje fort. Le të jetë ai streha jote, rruga jote, shpëtimi yt.

E lusim Allahun, ashtu siç lutej Pejgamberi ynë:

“O Bilal, na e qetëso zemrën me namazin!” (Hadith sahih)

E lusim Zotin të na bëjë prej atyre grave që falen me zemër, që jetojnë me sexhde e vdesin me besim.

A MUNDET ISLAMI TË BALANCOJË ETIKËN ME PROGRESIN MODERN?



Në botën tonë që po ndryshon me shpejtësi, sfidat me të cilat përballemi janë të ndërlikuara, duke kërkuar një qasje gjithëpërfshirëse që njeh rëndësinë e vlerave etike, shpirtërore dhe kulturore mes një mënyre jetese sekulare.¹

Çdo besimtar musliman ka përgjegjësinë të sigurojë që veprimet e tij të udhëhiqen nga një kuptim i thellë i ligjeve kombëtare, traditave të tyre dhe humanizmit të përbashkët që buron nga këndvështrimet dhe sistemet e besimit islam.

Gjatë dekadave të fundit, organizatat muslimane të angazhuara në mbarë botën islame kanë ofruar një plan veprimi për adresimin e çështjeve bashkëkohore, duke theksuar mesazhin universal të Islamit si një forcë dinamike për ndërtimin e kombit dhe fuqizimin e shoqërisë.

Ndërsa janë hartuar iniciativa të ndryshme për të përcaktuar një rrugë drejt realizimit të vërtetë të fuqizimit dhe ndërtimit të kombit, muslimanët, pavarësisht racës dhe etnisë së tyre, duhet të përqafojnë bindjen se ideja e bashkëjetesës domethënëse duhet të artikulohet në mënyrë të thellë nga ata që mishërojnë drejtësinë, dhembshurinë dhe një ndjenjë të thellë përgjegjësie - vlera që Islami dhe qytetërimet e mëdha të historisë kanë mbajtur si parime thelbësore.

Prandaj, është një sfidë e rëndësishme për të gjitha komunitetet muslimane të zhvillojnë një kulturë dijeje që ndërton kombe jo vetëm të begata, por edhe të drejta, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në parime morale. Duke pasur parasysh qasjen "jo-tevhidike" ndaj zhvillimit ose dualizmin, nuk ka dyshim se koncepti i fuqizimit shpesh lidhet me mënyrën se si anëtarë të veçantë të një komuniteti marrin pjesë në reforma politike, ekonomike dhe institucionale.

Megjithëse pjesëmarrja aktive në sferat sociale është një masë e rëndësishme e fuqizimit, një qasje gjithëpërfshirëse ndaj fuqizimit shkon përtej suksesit material dhe përparimit teknik.

Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj fuqizimit, e cila përfshin dimensionet shpirtërore, etike dhe kulturore të jetës njerëzore, duhet të pasqyrohet në kulturën tonë të dijes. Megjithatë, për shkak të qasjes dualiste në arsim, shumë politikëbërës mund të vënë në dyshim ligjshmërinë e saj, pasi duket se bie në kundërshtim me kushtetutën që mbështet konceptin e ndarjes së fesë nga shteti.

Duke shkuar përtej diskursit të zakonshëm mbi bashkëjetesën paqësore, e cila kap thelbin e harmonisë sociale, promovimi i qeverisjes etike dhe krijimi i një mjedisi ku individët mund të zhvillohen jo vetëm si qytetarë të mirë, por edhe si agentë moralë, shpesh pengohet nga një kulturë e dijes që përparon një qasje materialiste. Kjo qasje ka prirjen të anashkalojë aspektet më të thelluara dhe cilësore të bashkëjetesës - ato që lidhen me identitetin, udhëheqjen morale dhe drejtësinë

sociale.

Duke qenë të vetëdijshëm për mangësitë e qasjes konvencionale ndaj bashkëjetesës, dijetarët muslimanë në rajon janë angazhuar me homologët e tyre për të rikontekstualizuar qeverisjen etike, e cila thekson vlerat morale, transparencën dhe llogaridhënien në sferën publike si një strategji për të nxitur një narrativë kombëtare për integrimin.

Përpjekjet e tyre të përbashkëta me organizatat joqeveritare për zbatimin e programeve të ndryshme që trajtojnë pabarazitë sociale, diferencat ekonomike dhe çështje të tjera që prekin komunitetet muslimane kanë ndihmuar në kapërcimin e përplasjes epistemologjike midis dy traditave të kundërta intelektuale.

Për më tepër, ruajtja e kulturës dhe identitetit të komuniteteve muslimane në rajon është marrë seriozisht nga shumë avokatë të bashkëjetesës paqësore për të përmirësuar qasjen konvencionale ndaj ndërtimit të kombit.

Si përgjigje ndaj sfidave të arsimit modern si një instrument shtetëror për integrimin kombëtar, drejtuesit muslimanë të arsimit gjenden në një moment vendimtar për të pozicionuar arsimin musliman. Ata ndajnë mendimin se adoptimi i një qasjeje holistike, siç është integrimi i primeve islame në kurrikulën ekzistuese, do të forcojë aftësinë e tij për të formuar jo vetëm individë të mirë, por edhe qytetarë të përgjegjshëm.

Politika të ndryshme qeveritare janë miratuar nga liderë të përgjegjshëm për t'i kushtuar vëmendje të veçantë rritjes dhe zhvillimit të të rinjve muslimanë, duke siguruar që ata të jenë të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre jomuslimanë brenda infrastrukturës aktuale arsimore, veçanërisht në kontekstin më të gjerë të ndërtimit të kombit.

Për të garantuar që zërat e komuniteteve muslimane të dëgjohen në nivel kombëtar, gjuha islame dhe themelet filozofike të dialogut ndërfaqësor duhet të artikuloohen me kujdes nga intelektualët e duhur. Përpjekjet e tyre duhet të synojnë ndërtimin e urave dhe nxitjen e harmonisë sociale, duke adresuar keqkuptimet rreth Islamit, kulturës dhe praktikave të tij, si dhe rolin e tij në integrimin kombëtar.

Prandaj, për të siguruar që zërat e pakicave muslimane të dëgjohen, liderët e komunitetit duhet të jenë aktivisht të përfshirë në proceset e hartimit të politikave kombëtare që pasqyrojnë nevojat dhe aspiratat e ndryshme të komuniteteve muslimane. Kjo përfshirje do t'i shndërrojë komunitetet muslimane në aktorë të rëndësishëm për realizimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe harmonike.

Duke u mbështetur në parimet islame të konsultimit (shura), pajtimit (sulh) dhe moderimit (vasatijeh) dhe duke i integruar gradualisht brenda sistemeve kombëtare, pritet që zërat e nënpërfaqësuar në përpjekjet për ndërtimin e paqes, veçanërisht ata të rrënjësor në traditat islame dhe

1. Burimi <https://www.islamicity.org/103397/can-islam-balance-ethics-and-modern-progress/>

praktikat indigjene, të marrin njohjen që meritojnë.

Prandaj, është përgjegjësi kolektive e çdo komuniteti të informuar të rishpikë një kulturë dijes që nxit ndërgjegjësimin mbi humanizmin tonë të përbashkët, i cili shërben si themel i përpjekjeve globale për paqe dhe transformim të konflikteve. Ky moment i rëndësishëm në zhvillimin e studimeve mbi paqen dhe zgjidhjen e konflikteve pasuron teorinë dhe praktikën aktuale, duke kontribuar në fuqizimin dhe ndërtimin e paqes të përqafuar nga bashkësia globale.

Mund të argumentojmë se një sintezë krijuese midis traditave të vjetra dhe qasjeve të reja për fuqizimin dhe ndërtimin e paqes do të ofronte përparësi të shumta për çdo komunitet. Është një sfidë monumentale për ne që të riangazhohim intelektualët dhe politikëbërësit në fushën e paqes dhe zhvillimit të qëndrueshëm, të mbështetur në themele filozofike të mirëfillta që respektojnë historinë, identitetin dhe aspiratat e ardhshme të individit.

Arsimi mbetet thelbësor për ruajtjen e identitetit musliman, me dijetarët islamë që mbrojnë një sistem që respekton traditën, ndërsa trajton sfidat e shkaktuara nga ndikimet laike. Roli i liderëve të komunitetit në këtë përpjekje është jetik, pasi ata punojnë për të reformuar sistemin arsimor dhe për të korrigjuar padrejtësitë historike.

Ndërsa lundrojmë nëpër kompleksitetin e peizazhit tonë kulturor, është thelbësore të njohim rolin kritik që kultura luan në formësimin e sjelljes dhe besimeve njerëzore. Në këtë ndërthurje idesh që po përjetojmë aktualisht, është vendimtare të theksojmë rëndësinë e një kulture të integruar të dijes, e cila mund të ndihmojë në përmirësimin e kornizës së ofruar nga Programet e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). Është detyra jonë morale si një komunitet global të rizbulojmë dhe promovojmë mesazhet universale të feve botërore, përfshirë Islamin.

Në një shoqëri që mund të pasqyrojë paragjykimet e së kaluarës, është koha e duhur të përpikemi për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës që feston dallimet tona. Iniciativa të tilla mund të bazohen në konceptin kur'anor të diversitetit të shprehur në parimin e li te'arafu, i cili thekson unitetin e jetës dhe njeh natyrën e ndryshme të komuniteteve tona.

Prandaj, dijetarët muslimanë - të cilët janë shkencëtarë të mirëfilltë shoqërorë dhe "mjekë të vërtetë" për popullin - duhet të bashkohen për të gjetur zgjidhje që adresojnë rrënjët e përplasjes epistemologjike midis dy kulturave të kundërta në kontekstin tonë bashkëkohor.

Si liderët tradicionalë, ashtu edhe ata modernë muslimanë kanë paraqitur pikëpamjet e tyre mbi mënyrën se si mund të forcohen strategjitë qeveritare për menaxhimin efektiv të diversitetit kulturor përmes arsimit. Për shkak të përkushtimit të shtetit ndaj parimit të ndarjes së fesë nga shteti, përparimi i arsimit laik

asimilues është adoptuar si një masë qeveritare për bashkëjetesën paqësore në rajonet muslimane.

Duke ndarë aspiratat e liderëve të komuniteteve shumicë-muslimane në rajon, intelektualët muslimanë kanë qenë të angazhuar në ridimensionimin e rolit të Islamit në shoqërinë bashkëkohore, duke u përqendruar në mënyrën se si ai mund t'i shërbejë më së miri interesave të komuniteteve muslimane moderne.

Duke pasur parasysh ndërveprimet intelektuale midis dijetarëve muslimanë në rajon dhe botën më të gjerë islame, kemi qenë dëshmitarë të një dimensionit të ri të paqes dhe sigurisë, i cili mbështetet në objektivat e larta të ligjit islam (Mekasid esh-Sheriah). Ky koncept synon ruajtjen e interesave thelbësore njerëzore: fesë (din), jetës (nefs), intelektit ('akl), gjenealogjisë (nesl) dhe pasurisë (maal).

Megjithëse njohja e rëndësisë së këtyre parimeve mbetet ende në fazën e saj fillestare, nuk ka dyshim se zbatimi i tyre mund të luajë një rol vendimtar në arritjen e paqes së qëndrueshme dhe përmirësimin e sigurisë kombëtare, duke adresuar shkaqet rrënjësore të konfliktit dhe duke promovuar drejtësinë sociale, zhvillimin dhe harmoninë.

Duke pasur parasysh shkëmbimin intelektual midis liderëve të komunitetit në rajon, duket se përvoja unike e malajzianëve në kuptimin e diversitetit, dialogut ndërfaqetor, drejtësisë sociale dhe iniciativave për barazi, përfshirjes politike, demokracisë së udhëzuar dhe kultivimit të arsimit dhe ndërgjegjes kulturore gjithëpërfshirëse ka kontribuar në pasurimin e kornizës së liderëve të komunitetit, ndërsa ata rishikojnë qasjet e kaluara qeveritare për promovimin e përfshirjes dhe respektit të ndërsjellë midis komuniteteve të ndryshme muslimane në Filipine.

Krijimi i qytetarëve që mbajnë parimet e bashkimit kombëtar dhe që udhëhiqen nga mësimet e kulturës dhe traditës së tyre është shqetësimi i çdo mbrojtësi të paqes.

Në çdo komunitet, kontributet e liderëve të tij për historinë, kulturën dhe shoqërinë në përgjithësi duhet të njihen. Si të tillë, ata duhet të konsiderohen si institucione të respektuara kur ata arrijnë kualifikimet e nevojshme të udhëheqjes, fuqizohen përmes mekanizmave formalë dhe fitojnë besimin e qeverisë në idetë e tyre. Për më tepër, ata disponojnë autoritetin moral për të kundërshtuar padrejtësinë dhe për të mundësuar pajtimin.

Iniciativat e fundit për zhvillimin e bankave islamike, financës dhe industrisë halal në një shtet sekular kanë tërhequr vëmendjen e politikanëve, duke theksuar rëndësinë e liderëve dhe intelektualëve muslimanë në riformatimin e peizazhit ekonomik të vendit.

Ndërsa ecuri drejt një komuniteti të informuar dhe të gatshëm për të kuptuar thellësisht kompleksitetin e çështjeve shumicë-pakicë në ASEAN, të cilat janë

të ngulitura në ndërveprimin e faktorëve historikë, politikë, shoqërorë dhe kulturorë, ne përballemi me sfida që rrjedhin nga qasjet ekskluziviste për fuqizim dhe ndërtimin e paqes në forma dhe nivele të ndryshme. Rasti i komuniteteve muslimane në Filipine nuk është përjashtim.

Është e rëndësishme të theksohet se janë organizuar disa dialogje ndërfaqetare dhe ndërkulturore si përgjigje ndaj dështimit të mekanizmave të qeverisë për integrimin kombëtar dhe iniciativat për paqen.

Duke parashikuar pasojat e një koncepti të ngushtë të paqes, si thjesht mungesa e luftës - pavarësisht nëse ajo është mes kombesh, grupeve, apo brenda një vendi - përveç trajtimit të problemeve më të thella të dhunës strukturore, shkeljes së të drejtave të njeriut, shfrytëzimit, marginalizimit dhe përjashtimit politik, ne kemi vërejtur një tendencë të re mendimi mes intelektualëve dhe liderëve të rinj. Ata kërkojnë një harmoni mes epistemologjisë monoteiste tevhide dhe epistemologjive moderne brenda një konteksti sekular.

Në ndjekjen e një diskursi për paqen dhe fuqizimin që mbështet parimet e civilizimit njerëzor, të cilat i japin merita paqes së qëndrueshme në vend të asaj të përkohshme, ka lindur nevoja që liderët e komunitetit musliman të avancojnë kuptimin e reformës (islah), rinovimit (texhid) dhe rindërtimit (i'adatu'l-bina') të dijes dhe shoqërisë bashkëkohore, duke ndjekur botëkuptimin e monoteizmit islam (tevhid) dhe mësimet e tij universale, mes një qasjeje sekulare për paqen.

Besoj se të gjithë e ndajmë mendimin se, përmes një sinergjie kuptimplotë të kulturave të dijes që theksojnë rëndësinë e fesë, pritet që si komunitetet muslimane, ashtu edhe ato jo-muslimane në rajon të fuqizohen shpirtërisht dhe intelektualisht për të kuptuar thelbin e marrëdhënies së tyre me Krijuesin, me bashkëkombasit e tyre, fqinjët, qytetarët e tjerë, të huajt, mjedisin natyror dhe me vetveten.

Ka qenë një sfidë e vërtetë për liderët e komunitetit musliman dhe intelektualët që të riformulojnë një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe një set të plotë ligjesh për të drejtuar çështjet e muslimanëve brenda një shteti sekular.

Kur mendimi sekular, siç është përqaftuar nga shteti qeverisës, ka dështuar të ofrojë zgjidhje gjithëpërfshirëse për problemet e ndërlikuara që përballen komunitetet pakicë, bëhet detyrë e individëve të informuar mirë të rrëzojnë shkaqet e tij duke ftuar me guxim të gjithëve të rishikojnë pikat kyçe të kthesës që sollën ide dhe kultura kundërshtuese në terma të përbashkët.

Ky qasje është ndjekur nga disa organizata muslimane si Këshilli i Ulamas së Filipineve, Këshilli i Imamëve të Filipineve dhe Këshilli i Filipineve për Paqe dhe Demokraci për të rezonuar perspektivën monoteiste të dinjitetit njerëzor, lirisë së besimit dhe fuqizimit

intelektual, veçanërisht për të rinjtë, te institucionet e sponsorizuara nga qeveria që janë të ngarkuara si agjentë të paqes dhe reformës.

Megjithatë, për shkak të dobësimit të institucioneve islame dhe teprimit të besimit në idetë dhe qasjet sekulare, është shfaqur një vakum intelektual për shumë anëtarë të komunitetit në kërkimin e identitetit të tyre.

Sfida reale për çdo lider dhe intelektual të komunitetit në rajon është të identifikojë karakteristikat kryesore të arsimit islam dhe sistemeve të dijes që mund të udhëheqë komunitetin global drejt rolit transformues të tij, siç u pa gjatë kulmeve kulturore të civilizimit islam.

Sigurisht, besimi i treguar nga shtetet anëtare të ASEAN në udhëheqjen e Malajzisë si kryetar i ASEAN 2025 mund të lidhet me shumë faktorë, një prej të cilëve është prania e një kulture njohurish që respekton pluralizmin dhe nxit bashkimin brenda diversitetit.

Duke pasur parasysh thellësinë dhe gjerësinë e sekularizmit, veçanërisht pasojat e tij për integrimin kombëtar, do të ishte më strategjike për qeverinë, intelektualët dhe politikanët të përqafojnë një sistem të balancuar drejtësisht që ishte shpërndarë zakonisht nga komunitetet muslimane në rajon para kolonializmit. Sfida reale është si të rishpikim një kulturë alternative të dijes brenda kontekstit të një shteti sekular që do të ofronte privilegje për politikanët që të akomodojnë kuptimin e vërtetë të integritetit të shpirtit, intelektit dhe trupit përmes arsimit.

Politikat qeveritare të pazgjidhura me mangësitë e brendshme për shkak të paragjyqimeve dhe diskriminimeve ndaj pakicave muslimane duhet të trajtohen objektivisht dhe me sinqeritet nga ana e qeverisë dhe komuniteteve muslimane.

Për të trajtuar integrimin social në tërësinë e tij, ne duhet të kemi një njohuri të shëndoshë të natyrës njerëzore, për të cilën perspektiva shariatike është një dimension i rëndësishëm; njohuri për pakicat kulturore dhe zhvillimin e tyre; njohuri për vlerat e komuniteteve të tyre, dhe njëkohësisht për dobësitë e brendshme që mund të shfrytëzohen dhe korruptohen lehtësisht nga disa individë për qëllime të këqija.

Është e rëndësishme të theksohet se komunitetet muslimane janë në kërkim të vazhdueshëm të modeleve dhe mendimeve zhvillimore. Nëse atyre nuk u ofrohen modele gjithëpërfshirëse dhe perspektiva holistike të jetës, ata do të kërkojnë një model të gabuar dhe një sistem të rremë mendimi.

Në dritën e këtyre vëzhgimeve, të dyja palët, studiuesit dhe politikanët muslimanë dhe jo-muslimanë në rajon duhet të përqafojnë një kuptim më të gjerë të integritetit, që mund të rezultojë në funksionimin e një shoqërie të balancuar drejtësisht në kohën dhe hapësirën e caktuar.

Përktheu me shkurtesa Haki Sahitaj

Kurbani

thelbi sublim i bindjes
dhe përkushtimit



Kurbani është një shprehje përkushtimi, sakrifice, singeriteti dhe nënshtrimi ndaj vullnetit hyjnor. Ky nënshtrim e përkushtim simbolizohet në mënyrë kulmore me Ibrahimin dhe Ismailin, dy profetët e Zotit.

Ngjarja e treguar në Kur'anin Fisnik (Safat, 100-107) paraqitet si një horizont në emër të bindjes dhe nënshtrimit ndaj urdhrave të Allahut për besimtarët. Ç'përkushtim, besim e bindje e jashtëzakonshme vërehet te Ibrahim?! Për vite të tëra zemra i ishte djegur nga dëshira për të pasur një fëmijë. Allahu i dhuroi një djalë kur ishte në moshë të thyer. Më pas, kur djali e kaloi moshën e fëmijërisë dhe mbërriti në moshën që mund të rendte pas të atit, të shoqërohej e të punonte me të, Ibrahim pa në ëndërr se i duhej ta flijonte atë. Ai e kuptoi se kjo ëndërr ishte një shenjë prej Zotit të tij, që i urdhëronte të bënte të birin kurban. E pra, ajo që ai shihte në ëndërr ishte veç një shenjë e jo një zbulësë e qartë. E megjithatë, kjo ishte e mjaftueshme që Ibrahim të përulëj përpara urdhrat të Allahut dhe t'i shprehte Atij bindje të plotë. Ndërkohë, ajo që po i kërkohej nuk ishte që ta dërgonte të birin në luftë apo t'i urdhëronte diçka që mund t'i kushtonte jetën, por po i kërkohej ta flijonte atë me duart e veta. Ibrahim, i cili ishte në një dorëzim e nënshtrim të plotë, me paqe e qetësi të brendshme, pa se edhe i biri, Ismaili gëzonte të njëjtin përkushtim e nënshtrim. Atë e bir, në kulmin e përkushtimit ndaj Allahut, pranuan për ta çuar në vend atë që u kërkohej. Kur Ibrahim e përgatiti të birin duke e shtrirë për ta flijuar, Allahu i Lartësuar i bëri të ditur se e kaloi sprovën dhe i dërgoi një dash kurban për ta flijuar në vend të tij. Kështu, kujtimi i kësaj ngjarjeje të madhe që lartohet si pishtar i bukurisë së bindjes dhe i madhështisë së përkushtimit, vijohet sot e kësaj dite me traditën e therjes së kurbanit. Profeti ynë, duke tërhequr vëmendjen për këtë çështje, ka urdhëruar e ka thënë: **"Thëni kurban, sepse therja e kurbanit është shembulli i atit tuaj, Ibrahimit"** (Ibnu Maxhe, Edahi, 3)

Kurbani zhvillon shpirtin e bindjes e të përkushtimit ndaj Allahut. Në këtë mënyrë, njeriu mbart në vetvete sjelljen e nënshtrimit ndaj Zotit, përpiket të vërë në vend detyrën e mirënjohjes, i afrohet Allahut dhe kështu kurban kthehet në një shkak për këtë afri hyjnor.

Veç kësaj, kurban ka vlera të veçanta edhe në jetën shoqërore. Kurban nxit dhe zhvillon shpirtin e vëllazërimit, të ndihmës, të sakrificës e të mbështetjes tek njëri-tjetri. Ai ndihmon në

zhvillimin e drejtësisë, siguron një ndihmesë domethënëse në kapërcimin e hendeqeve mes shtresave shoqërore dhe në njohjen, afrimin dhe shkrirjen e ngurtësive mes individëve të niveleve të ndryshme.

Në jetën e njerëzve të varfër, që nuk janë në gjendje të mirë materiale, kuptohet qartë mirësia e bereqeti i këtij ibadeti. Kurban e mëson të pasurin që të dhurojë nga malli i tij për të fituar kënaqësinë e Allahut. Ai nxit ndihmën e ndërsjellë dhe bën të ndihet në shpirt kënaqësia e dhurimit dhe e ndihmës.

Kurbani bëhet shkak që edhe i varfri të falënderojë Allahun. Njeriu i varfër, në saje të kurbanit, çlirohet prej pesimizmit dhe armiqësisë që mund të ndiejë për arsye të shpërndarjes së të mirave materiale në këtë botë dhe kupton se shoqëria në të cilën jeton tregon vëmendje ndaj tij.

Krahas gjithë atyre sa u thanë, për kafshën e therur për hir të Allahut janë premtuar shumë e shumë shpërblime.

Ebu Saidi rrëfen se ka dëgjuar Profetin (a.s.) të thotë: *"Ngrihu o Fatime e shih therjen e kurbanit, se për çdo pikë që pikon nga gjaku i tij shpërblehemi me faljen e mëkateve që kemi bërë më parë. Ajo e pyeti: -O i dërguari i Allahut! Është kjo vetëm për Ehli Bejtin, apo për të gjithë myslimanët? Ai tha: Për ne dhe për të gjithë myslimanët."*

Muslimani që e ther kurbanin me zemër të pastër dhe singeritet, Ditën e Gjykimit do të shpërblehet mirë tek Zoti. Pejgamberi ynë për këtë çështje shprehet: *"Ditën e kurbanit nuk ka asnjë vepër të birit të Ademit më të dashur tek Allahu se sa therja e kafshës. Ai kurban vjen ditën e gjykimit me bërë, lëkurën dhe thundrat e tij. Gjaku i kurbanit tek Allahu ka një vlerë të madhe. Kurban pranohet para se gjaku të bjerë në tokë. Paraqitni kurbanet tuaja tek Allahu me një zemër të pastër dhe të singertë."* (Tirmidhi, Edahi 1)

Kurbani mbart edhe plot vlera që ne ende nuk i njohim. Adhurimet, më shumë sesa për çdo vlerë e dobi jetësore që mund të kenë, duhen kryer vetëm për hir të Allahut. Në këtë kuptim, krahas çdo dobie individuale e shoqërore, kurban është një adhurim që kryhet për të arritur kënaqësinë e Allahut. Në Kur'an lexojmë: **"Këtë mos e harroni, se as mishi i tyre (i kurbaneve), as gjaku i tyre asesi nuk mbërrin tek Allahu. Ajo çka mbërrin tek Ai është vetëm përkushtimi që ushqeni në zemrat tuaja, është respekti për Allahun..."** (Haxh, 22/37)

QABJA E MADHNUESHME

vendi i shenjtë i myslimanëve



Qabja është Shtëpia e shenjtë e Zotit, që ndodhet mu në mes të Xhamisë së Shenjtë të qytetit të Mekës, në Arabinë Saudite. Kubi i zi në atë formë të bukur e stoike, është mjaft i njohur për njerëzit e të gjitha besimeve, për shkak të pamjeve që përcillen nga Arabia Saudite çdo vit gjatë kohës së kryerjes së haxhit. Zakonisht, kur njerëzit hasin këto pamje, gjithë vëmendja e tyre përqendrohet te kubi i zi që qarkohet nga mijëra-mijëra adhurues të Zotit. Kjo është Qabja. "Allahu e bëri Qaben, Shtëpinë e Shenjtë, një vend jetësimi (për çështje të fesë dhe të jetës) për njerëzit, për muajin e shenjtë dhe kurbanin..." (Kur'ani, 97).

Qabja është vend i shenjtë sipas fesë Islame, ndërkohë që kibla është drejtimi që myslimanët marrin kur i drejtohen ritit të faljes. Quhet Qabe, ngaqë ka një formë të tillë, fjala ka'b, në gjuhën arabe do të thotë kub. Ka raste që Qabja njihet edhe si El Bejt El Atik, apo shtëpi e lirisë. Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë se i është vënë ky emër për shkak se Zoti e mbrojti atë nga rënia nën sundimin e tiranëve. Qabja është ndërtuar me gur graniti të sjellë nga kodrat pranë Mekës, ajo është 15 metra e lartë, ndërsa përmasat anësore 10.5 X 12m. Sot, Qabja është e mbuluar me një copë mëndafshi të zi të zbukuruar me një shkrim të qëndisur me fije të arta, që njihet ndryshe si Kisuah. Në pjesën jugperëndimore të Qabes ndodhet një mur gjysmë-hark, që përfaqëson kufirin, ose siç njihet ndryshe el hatim. Hyrja për në Qabe mundësohet përmes një porte 2.13 metra të lartë, që ndodhet nga ana veri-lindore e murit. Brenda, dyshemeja është prej mermeri dhe muret janë të veshura po me mermer, deri në gjysmë lartësi. Ajetet kuranore janë shkruar në lastra të vendosura në brendësi të mermerit dhe pjesa e sipërme e murit të brendshëm është e veshur me copë në ngjyrë të gjelbër dhe zbukuruar me shkrime të qëndisura me fije të arta.

Llambadari është i varur në një shtyllë transversale, atje ndodhet edhe një tryezë e vogël për aromatizuesit. Kujdestarët e Qabes e parfumosin edhe mermerin e veshur me aromatizues vajor. I njëjti aromatizues përdoret për të vajosur edhe pjesën e jashtme të Gurit të Zi. Guri i Zi, një gur i lashtë dhe i bekuar, është i vendosur në pjesën lindore të Qabes, një metër e gjysmë mbi tokë. Profeti Muhamed ka thënë: "Guri i Zi ka zbritur nga Xheneti dhe ka qenë më i bardhë se qumështi, por gjynahet e bijve të Ademit e kanë bërë të

zi". Studiuesit myslimanë ndajnë mendime të ndryshme se kush e ka ndërtuar Qaben. Disa thonë se është ndërtuar prej engjëjve. Të tjerë janë të mendimit se babai i njerëzimit, Ademi (a.s.), është ai që ndërtoi Qaben, por pasi kaluan disa shekuj moskujdesjeje, ajo që rrënuar, për shkak edhe të trazirave të kohës. Më pas u rindërtua nga profeti Ibrahim dhe djali i tij Ismaili (a.s.). Të gjithë bien në një mendje se Qabja është ndërtuar a rindërtuar nga profeti Ibrahim (a.s.). "Dhe (kujto) kur Ibrahim dhe (djali i tij) Ismaili ngritën themelet e Shtëpisë (Qabes në Mekë), (duke thënë) "Zoti ynë! Prano (këtë shërbim) prej nesh. Me të vërtetë, Ju jeni i Gjithëdëgjueshmi, i Gjithëdijshmi!" (Kur'ani, 17).

Që nga ajo kohë, Qabja është rindërtuar disa herë. Nga amalekitët, fisi i Jurham-it, Qusayy ibn Kilaab, nga fisi i kurejshëve dhe disa herë të tjera pas shpërfaqjes së Islamit. Shkurt, përpara se të niste misioni i profetit Muhamed (a.s.), Qabja ishte e ndërtuar me gurë, pa çimento, dhe nuk ishte më e lartë se një shtat njeriu. Njerëzit i patën vjedhur thesaret nga Qabja, kështu që kurejshët vendosën ta rindërtojnë dhe t'i vënë çati. Çdo fis mblodhi materiale ndërtimi dhe punuan së bashku deri sa erdhi koha që të vendosej në të edhe Guri i Zi. Për shkak të bujës që shkaktoi vendosja e Gurit të Zi, argumentet shpërthyen sheshit. Abu Umejah ibn el Mugirah, një prej më të vjetërve në moshë, tha: "O kurejshë, bini në një mendje për çka po grindeni. Lëreni të parin që do të vërë këmbë në këtë Portë, që të vendosë për çështjet tuaja". I pari që vuri këmbë në derë ishte Muhamedi (a.s.), i njohur deri asokohe si El Emin (besniku). Ai dha mendimin që ta vendosnin Gurin e Zi në një pelerinë, secili nga fiset të mbante një cep të saj dhe fama do të shpërndahej njëtrajtësisht mes fiseve. Guri i Zi mbërriti në Qabe pikërisht në këtë mënyrë, dhe më pas, Muhamedi e vendosi gurin në vendin e tij.

Qabja përbëhet nga katër qoshe. Së fundi, është mjaft e rëndësishme të kuptohet se ne myslimanët nuk adhurojmë Qaben apo çfarë gjendet rrotull saj. Ne adhurojmë vetëm se Zotin e Qabes, Allahun e Madhëruar, i cili nuk ka ortak e as shok dhe askush e asgjë tjetër përveç Tij nuk e meriton adhurimin. Ajo është thjesht kibla, e cila ka rëndësi mjaft të veçantë përse i përket simbolikës dhe është një drejtim të cilin marrin myslimanët për t'u falur. Prandaj edhe mbart kaq rëndësi.

Vetëm kush vjen *me zemër të pastër...*



Njeriu është qenie emocionale dhe çdo situatë që e rrethon, ai është i prirur t'i qaset asaj emocionalisht. Kjo ndjenjë emocionale që e ka burimin në zemër, e çon njeriun drejt veprimeve.

Allahu na lajmëron në Kur'an duke nanthënë: **"Ai i ditë fshehtat e shpirtave tuaj"** (Bekare 284), duke i dhënë njeriut me anë të këtij ajeti një përgjegjësi mbi mendimet dhe emocionet e tij.

Mirëpo a mundet njeriu t'i kontrollojë mendimet dhe emocionet?! Sigurisht që jo. Prandaj dhe mbas shpalljes së këtij ajeti, shokët e Profetit (a.s) ishin në kufi të pamundësisë së zbatimit të përgjegjësisë së çështjes në fjalë, por kur ata vendosën që do i binden Zotit edhe në këtë çështje, atëherë Allahu e lehtësoi çështjen duke thënë: **"Allahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij"** (Bekare 286).

Ky ajet na ka përgëzuar se nuk do të merremi në llogari për mendimet tona, për sa kohë që përpigemi t'u largohemi këtyre mendimeve dhe ndjenjave shpirtërore, e nuk i kthejmë ato në veprime konkrete.

Pra duket qartë se veprimet e njeriut në të jashtmen, vijnë si pasojë e gjendjes së tij të brendshme. Këtu është shumë thelbësore të kuptojmë se sa e rëndësishme është që njeriu të përmirësojë zemrën e tij, sepse pastrimi i zemrës 'tezkiyetu'l-kalb', është shkak për të shpëtuar. Në Kur'an thuhet: **"Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë"** (Shems 9). Ndërsa ai që e ushqen shpirtin e tij me të keqen dhe të ligën, kjo gjë do t'i bëhet shkak për t'u shkatërruar. Në Kur'an, gjithashtu thuhet: **"Ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë."** (Shems 10).

Nuk ka diskutim se të kesh zemrën e pastër dhe të kesh mirësi në të, patjetër që do të jesh pro të drejtës dhe kundër të keqës. Një zemër e gjallë me besim, kultivon ndjenjat e mirësisë dhe dhembshurisë, gjë që më pas e shtyn

njeriun drejt veprave dhe gjykimeve të drejta.

Pikërisht Allahu e do të mirën dhe drejtësinë. Ai e do zemrën që prej saj buron mëshira dhe dhembshuria, ku për këtë fakt Ai fal dhe mëshiron njerëzit.

Shembulli i asaj gruaje të pamoralshme që Allahu e fali dhe mëshiroi për shkak se i dha ujë qenit prej mëshirës që ndieu në zemër, është shembulli konkret për këtë çështje.

Allahu thotë në Kur'an: **"...dhe ta dini se Allahu ndërhyt ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij..."** (Enfal 24).

Ky ajet komentohet nga dijetarët se Allahu shikon zemrat e njerëzve, dhe për këtë arsye Ai mundëson udhëzim në besim dhe falje prej gjynaheve.

Prandaj në Islam çështja e udhëzimit në besim është një urtësi ekskluzive e Allahut të Lartësuar, ku Ai thotë se: **"Udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë"** (Bekare 142).

Prandaj nuk është për t'u çuditur fakti se ndonjëherë shohim që janë afuar në besim dhe praktikë Islame njerëz që kurrë nuk do i mendonim se do mund të bëhen besimtarë, kjo për faktin se ne nuk e dimë se çfarë kanë ata në zemër, ngaqë këtë fshehtësi e di vetëm Zoti i botëve.

Kështu është shumë me vend të themi se: "Allahu i jep njeriut sipas asaj që njeriu ka në zemër," sepse siç na thotë profeti Muhamed (a.s): *"Allahu nuk shikon trupat dhe fytyrat, por ai shikon zemrën dhe punët tuaj"* (Muslimi).

Kjo është rruga e duhur që një besimtar duhet të ndjekë për të përmirësuar veten në raport me Allahun (xh.sh.) në këtë botë, në mënyrë që të meritojë falje dhe shpëtim në botën tjetër siç Allahu na shpreh në Kur'an: **"Dhe mos më turpëro në ditën kur do të ringjallen njerëzit. Në ditën kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët. Përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!" Atë ditë Xheneti do t'u afrohet besimtarëve të devotshëm".** (Shura 87-90)

Vlera e dhjetë ditëve të para të muajit Dhu'l-hixhe

Nuk ka dyshim se, sikundër që Allahu i ka dalluar disa vende nga disa të tjera, ose disa njerëz nga disa të tjerë, po ashtu i ka dalluar edhe disa ditë nga disa të tjera. Kështu, dhjetë ditët e para të muajit hënor Dhu'l-hixhe i ka dalluar nga ditët tjera të vitit. Ko-më-ntuesit e Kuranit (myfessirinët) janë të gjithë në një mendim kur konstatojnë se betimi i Allahut në Kuran e tregon pikërisht peshën dhe rëndësinë e këtyre ditëve. Në Kuranin Famëlartë, i Ma-dhi Zot është betuar duke thënë:

“Betohem në Agimin dhe në dhjetë netët (që iu paraprijnë dhjetë ditëve të muajit të dhu-hixhes), dhe në çiftin dhe në tekun...”¹

Dijetarët islamë, në radhë të parë shumica e myfessirinëve, kon-si-derojnë se këto ditë dhe gjithsesi edhe netët që iu paraprijnë aty-re, kanë vlerë dhe rëndësi të madhe, madje aq sa i Madhi Zot është betuar për to në Kuran. Kjo për faktin se, sipas mendimit të tyre, me dhjetë netët e përmendura në Kuran qëllimi është për ato që iu paraprijnë dhjetë ditëve të Dhu'l-hixhes.² Teku i përmendur në këtë ajet sinjalizon për ditën e nëntë të këtij muaji, ditën kur haxhi-lerët qëndrojnë në Arafat, kurse “çifti” i përmendur në ajet, ka të bëjë me ditën e dhjetë të dhul-hixhes, gjegjësisht për ditën e Bajra-mit.

Konstatimi i mësipërm, lidhur me rëndësinë e këtyre ditëve, është i mbështetur edhe në hadithin e Pejgamberit (a.s.):

“Ibni Abasi transmeton se si Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nuk ka ditë kur puna e mirë në to është më e dashur tek Allahu se sa puna gjatë këtyre ditëve (dhjetë ditëve të para të dhu'l-hixhes)”³! Madje, dikush e pyeti Pejgamberin çudi-t-shëm: Ja Resulullah, as edhe lufta në rrugë të Zotit?! Pej-g-amberi qe përgjigjur: “As edhe lufta në rrugë të Zotit, për-veç njeriut i cili shkon në luftë me veten dhe pasurinë e tij dhe kthehet pa asnjërin!”⁴

Ngjashëm me këtë, e kemi edhe hadithin e transmetuar nga Ibn Hanbeli nga Abdullah bin Ymeri, i cili transmeton hadithin e Pej-gamberit (a.s.) të ketë thënë: “Nuk ka ditë më të mëdha e më të preferuara te Allahu i Gjithëmëshirshëm për të bërë vepra të mira se sa në këto ditë, për këtë arsye, përmendeni shpesh Allahun me tehlil (Lâ ilâhe il-lallâh), me tekbir (Allâhu Ekber) dhe me tahmid (El-hamdulilâh)”⁵.

Prandaj, gjatë këtyre ditëve kaq të rëndësishme, së pari duhet të kemi kujdes maksimal e të mos bëjmë ndonjë vepër e cila është e ndaluar ose e shëmtuar dhe e cila e hidhëron Krijuesin e gjithësisë.

Nga ana tjetër, duhet të angazhohemi që sa më shumë të bëjmë vepra të mira: namaz nafle, tesbih: subhanallah, elhamdulil-lah, Allahu ekber, la haule ve la kuvvete il-la bil-lah, të japim sadaka, të lexojmë Kuran, të agjërojmë⁶, të bëjmë istigfar – kërkim falje, t'i drejtohem Allahut me lutje (dua), të marrim sa ma shumë tek-bire e telbije (lebbejk Allâhumme lebbejke...) etj. të ngjashme. Një punë të mirë e të dobishme që e bën besimtari në këto ditë, është sikurse të njëjtën ta ketë bërë për gjatë krejt vitit dhe shpër-bli-min e ka po aq të madh. Vetëm agjërimi i ditës së nëntë të këtij muaji (që është dita e Arefatit) për ata që nuk janë në haxh, bëhet sebeb që Allahu të na i shlyejë gjynahet e vitit të kaluar dhe atij që do të vijë. Kur e pyetën as'habët Pejgamberin (a.s.) për agjërimin e ditës së nëntë, ai pati thënë: “Agjërimi i ditës së nëntë të këtij mu-aji, bëhet shkak që Allahu t'i shlyejë gjynahet e vitit të kaluar dhe atij që do të vijë”⁷!

Përtej të gjitha këtyre që u përmendën dhe edhe shumë të tjera që nuk i kemi përmendur, është nijeti ynë i pastër, i sinqertë, është shpirti ynë i dëlirë, është përkushtimi ynë ndaj Allahut të Gjithë-pushtetshëm, kurse përmes këtyre

Abdullah ibni Abbasi.

5. Transmeton Ahmed bin Hanbeli

6. Agjërimin i nëntë ditëve të para të muajit Dhu'l-hixhe është i mirë dhe sevap për ata që nuk janë në Haxh, kurse ditën e dhjetë e që është dita e Bajramit dhe tri ditët në vazhdim nuk bën të agjërohen. Ato janë ditë feste, ditë argëtimi e ngrënie.

7. Transmeton Muslimi.

1. Kuran, El-Fexhr: 1-3.

2. Ka mendime se ato dhjetë net janë ato të fundit të Ramazanit, ndonëse mendimi i parë është më i pranueshëm.

3. Transmeton Buhariu.

4. Buhariu në Sahihun e tij, Davudi dhe Tirmidhiu nga

ibadeteve, ne duhet të synojmë të arrijmë kënaqësinë e Allahut (xh.sh.), që Ai të jetë i kënaqur me sjelljet dhe veprat tona.

Me këtë rast duhet thënë edhe këtë, se në këtë botë mbase mund të ketë edhe të tillë mendjelehtë që e minimizojnë rëndësinë e këtyre ditëve, nuk ua japin hakun ashtu siç ato e meritojnë. Këta harrojnë se tetë ditët e para sikur trokasën në ndërgjegjen e besim-tarit për t'u përgatitur për ditën e nëntë dhe të dhjetë. Dita e nëntë është dita e qëndrimit të haxhilerëve në Arafat, dita kur lutja e be-simtarit është e pranuar, është dita kur Allahu më së shumti li-ron nga zjarri i Xhehenemit. Ndërkaq, dita e dhjetë e Dhu'l-hixhes, është dita e Kurban Bajramit, dita kur i madh e i vogël i gëzohen kryerjes së kushtit të pestë të fesë islame-Haxhit, i gëzohen festës së Bajramit. Prandaj, prej nga ajo e "drejtë" që t'i nëpërkëmbim këto momente kaq domethënëse për të cilat Allahu edhe është be-tuar!!! Pejgamberi (a.s.) me një rast pati deklaruar: "Duaja më e mi-rë është ajo e Ditës së Arafatit, ndërkaq fjala më e mirë që e kam thënë unë dhe vëllezërit e mi pejgamberë para meje është "La ilahe il-la Allahu la sherike lehu, lehu-l-mulku ve lehu-l-hamdu ve huve ala kul-li shejin kadir"-!- "Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, Ai nuk ka ortak, Atij i takon sundimi dhe falënderimi, dhe, Ai është i mbifuqishëm mbi çdo gjë!" Se këto ditë janë vërtetë dhuratë nga i Madhi Zot për të fituar sevape të shumëfishta, e për të cilat kurdo-herë kemi nevojë, janë ditë kur Allahu lëshon mëshirë të madhe ndaj robërve të Tij. Ebu Derdai tregon: "Agjëroni nëntë ditët, bëni sa më shumë dua, kërkon falje dhe shpërndani sadaka. Kam dë-gju-ar Pejgamberin (a.s.) të thoshte: "Mjerë për atë që e lëshon ras-tin dhe mjerë për atë që ia shkurton vetes vlerën e këtyre dhjetë ditëve. Në veçanti, mundohuni që ta agjëroni ditën e nëntë. Atë ditë ka aq shumë mirësi sa është e pamundur të numërohen!"

E, pra, jemi para një rasti shumë ideal që të fitojmë sevape, të shlyejmë gjynahe, të fitojmë kënaqësinë e Allahut, Ai të kënaqet me ne e ne të kënaqemi me Të. Kjo tashmë është në dorën tonë: kushdo e merr, sikundër që kushdo e refuzon! E tëra varet nga vullneti dhe gatishmëria jonë!!!

Ibn Haxheri ka thënë: "Me sa duket iu është dhënë përparësi kë-tyre ditëve ndaj të tjerave, sepse në këto ditë gërshetohen disa adhurime kryesore si: namazi, agjërimi, haxhi, sadakaja, e nuk bë-het një gërshetim i tillë vetëm se në këto ditë."

Transmetohet nga Ibni Abbasi (r.a.) se si Pejgamberi (a.s.) kishte thënë:

"Dita kur i është falur mëkati Ademut (a.s.) është dita e parë e dhul-hixhes, e kush e agjëron atë ditë do t'i falen të gjitha mëkatet.

Ditën e dytë të dhul-hixhes, Allahu ia kishte pranuar duanë e Junusit (a.s.) dhe e shpëtoi nga barku i peshkut (balenës), kështu që kush e agjëron këtë ditë është sikur të bënte iba-det tërë vitin.

Dita e tretë e Dhul-hixhes është dita kur është pranuar du-a-ja e Zekerijait (a.s.), prandaj kush agjëron atë ditë do t'i pranohet duaja.

Dita e katërt është dita kur ka lindur Isai (a.s.), kështu që kush e tejkalon atë me agjërim, Allahu do t'ia largojë atij çdo dëshpërim, varfërinë dhe se në Ditën e Gjykimit do të jetë me të përzgjedhurit e Allahut.

Dita e pestë është dita e lindjes së Musait (a.s.), prandaj kush e agjëron atë ditë do të jetë i shpëtuar nga hipokrizia dhe dënimi në varr.

Dita e gjashtë është dita kur Allahu i ka dhuruar Pejgam-be-rit të tij çdo mirësi (hair) e kush e kalon atë me agjërim, Allahu do ta mëshirojë dhe do ta shpëtojë nga çdo dënim.

Dita e shtatë është dita kur mbyllen dyert e xhehenemit dhe nuk hapen deri pasi të kalojë dita e dhjetë e dhul-hixhes, pra-ndaj kush e agjëron atë ditë Allahu do t'ia mbyllë tridh-jetë dyer të çdo vështirësie dhe do t'ia hapë dyert e lehtë-simit.

Dita e tetë është dita që quhet "Jeumut-tervije", kush e agjëron atë do të shpërblehet me dhurata të mëdha, dhuratë kjo vlerën e të cilës nuk e di kush përveç Allahut (xh.sh.).

Dita e nëntë është dita e cila quhet "Jemu Arefete" d.m.th. Dita e Arafatit, prandaj kush e agjëron atë, do të jetë keffa-ret për vitin e kaluar dhe vitin që vjen. Kjo është dita kur Allahu e ka shpallur: "Sot e kam përsosur fenë tuaj, e kam plotësuar dhuntinë Time ndaj jush, dhe jam i kënaqur që Islami të jetë fe e juaj".

Dhe dita e dhjetë është "Jeumul-ed'ha", prandaj kush ther kur-ban këtë ditë, me rënien e pikës së parë të gjakut të kur-banit në tokë, atij dhe familjes së tij i falen mëkatet. E. kush e ushqen një besimtar ose ndan sadaka atë ditë, atë do ta ringjallë Allahu Ditën e Gjykimit të sigurt dhe terezia (pe-sho-rja) e veprave të tij do të peshojë më rëndë se kodra e Uhudit"⁸.

Lusim Allahun (xh.sh.) të na e shtojë dashurinë ndaj Zotit të Lartësuar, të na forcojë imanin tonë, të na rrisë dëshirën për të bërë vepra të mira, të na e rrisë dashurinë vëllazërore, të na e mundësojë që në këto ditë të para të këtij muaji të bekuar ta shtojmë ibadetin tonë!

Lusim Allahun e Gjithëmëshirshëm që popullin tonë ta ruajë nga kjo pandemi, nga kjo bela me të cilën jemi sprovuar! E lusim Zotin të na i falë gjynahet tona, e nesër në Ditë të Ahiretit të mos na ndajë nga bajraku e Muhamed-Mustafasë duke na shpërblyer me Xhenet! Dhe lutja jonë e fundit: Falënderimi i takon Allahut - Zotit të botëve!

8. Këtë hadith, me këtë tekst, e ka përmendur Othman bin Hasan bin Ahmed Esh-Shakir El-Hubevij, njëri ndër dijetarët e shek. të trembëdhjetë hixhri në veprën e tij "Durretu en-Nâsihîn fil-Va'dhi vel-Irshâd", f. 281. Had-ithi konsiderohet daif-i dobët dhe nuk përmendet në koleksionet e hadithit. E shënuam këtu sepse nuk ka ndonjë dispozitë e cila obligon për ndonjë veprim, por bëhet fjalë për vepra të cilat nxisin në vepra të mira, të cilat nëse i bën fiton derexhe ibadeti, e nëse jo, nuk ka ndonjë dënim.

Pena është një pemë,
frytet e saj janë fjalët



Kur lapsi takoi gomën, atëherë kjo e pyet lapsit:

Si je miku im?

Lapsi iu përgjigj me inat: Unë nuk jam miku yt! Unë të urrej ty!

Pse? Me habi dhe pikëlim i tha ajo.

Sepse ti fshi atë që shkruaj unë! - i tha ai.

Unë i fshij vetëm gabimet! - i tha ajo.

Çfarë pune bënë ti? - i thotë ai.

Unë jam gomë dhe kjo është puna ime! - i thotë ajo.

Kjo nuk është punë! - i tha ai.

Puna ime është po aq e dobishme sa e jotja! - i tha ajo.

E ke gabim dhe je fodulle, sepse ai që shkruan është më i mirë se ai që fshin! - i tha lapsi

Heqja e gabimit është e barabartë me shkrimin, që është plotësisht e saktë! - i tha ajo.

Lapsi heshti për një çast, pastaj i drejtohet me pak pikëllim: Megjithatë, po të shoh që po bëhesh gjithnjë më e vogël dita ditës! Sepse sa herë që fshij një gabim sakrifikoj diçka nga vetja! - i tha ajo.

Atëherë lapsi i tha me një zë të ngjirur:

Po ashtu edhe unë po ndjej se jam më i shkurtër se sa isha!

Më pas goma i thotë duke e ngushëlluar:

Ne nuk mund t'u bëjmë dobi të tjerëve, nëse nuk bëjmë një sakrificë për ta! Pastaj goma e shikoi lapsin me shumë simpati dhe e pyet: A më urren ende?

Lapsi buzëqeshi ëmbël dhe i tha: Si mund të të urrej ty, kur neve 'sakrifikimi' për këtë botë na bashkon?!

- Çdo ditë që zgjohesh, jeta jote do të pakësohet me një ditë!

- Nëse nuk mund të jesh një laps për të shkruar lumturinë për të tjerët, atëherë bëhu një gomë e butë, me të cilën do të fshish dhe pikëllimet e tyre dhe të përhapësh shpresën dhe optimizmin në shpirtat e tyre se e ardhmja është më e bukur, në dashtë Zoti!

MILIONA HAXHINJ - MILIONA DASHURI

U nisën, po nisen
Nga toka, deti dhe qielli
Atje ku lindi Dielli
Për të vizituar
Vendin e Shenjtëruar
Qaben e Madhëruar
Mekën e Bekuar
Për të zbritur
Në Medinen e Ndritur...
Milion haxhinj
Milion dashuri
Nga të dy gjinitë
Po i lënë shtëpitë
Po i lënë foletë
Po i lënë atdhetë
Me mall, me lot,
Por me shpirtin plot
Veç për t'Madhin Zot...
Milion haxhinj
Milion dashuri
Të bardhë e të zinj
Të vjetër e të rinj
Radhë-radhë këndojnë
Allahun e Madhërojnë
Para Tij nënshtrohen
Para Tij pendohen...
Haxhinjtë shqiptarë
Rreth flamurit kombëtar
Me zemër të pastruar
Me shpirt të lartësuar
Kujtohen edhe për ne
Që jemi n'Atdhe:
Luten për Kosovën, Çamërinë
Luten për Shqipërinë.





VIJOJNË REGJISTRIMET

ZGJIDH TË ARDHMEN QË MËRITON

Mësimdhënie cilësore

Ambient i sigurt dhe i përkushtuar ndaj nxënësve

Edukim i plotë akademik dhe moral